



REPUBLIKA E SHQIPËRISË


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Lënda: Të dhënat kryesore të analizuar nga sistemi i prokurimit publik për vitin 2017

Prokurimi publik është një nga fushat kryesore të veprimtarisë shtetërore dhe një nga proceset më të rëndësishme në menaxhimin e financave publike.

Bazuar në të dhënat e siguruar nga INSTAT mbi Produktin e Brendshëm Bruto (PBB), rezulton se, **për vitin 2017, fondi total limit i prokuruar në Shqipëri, zë 7% të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB).**

Ndërkohë nga të dhënat e vendeve të rajonit dhe BE-së, rezulton se fondi buxhetor i shpenzuar për prokurime publike shkon mesatarisht nga 5-12% të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Konkretisht, një situatë krahasimore paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Fondi i kursyer në prokurimet elektronike, me vlerë mbi blerjen e vogël, të kryera gjatë vitit 2017, **rezulton në vlerën 8%**, të të gjithë fondit limit të prokuruar.



Gjatë vitit 2017, autoritetet kontraktore kanë përdorur gjithashtu **procedurën e prokurimit me vlerë të vogël** nën kufirin 800,000 lekë.

Fondi i kursyer në prokurimet elektronike, me vlerë të vogël, të kryera gjatë vitit 2017, **rezulton në vlerën 18%**, të të gjithë fondit limit të prokuruar.

Gjithashtu, gjatë vitit 2017 u lancua për herë të parë aplikacioni “E-Procurement Albania” për ofertimin në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël nëpërmjet smartphone, duke rritur ndjeshëm konkurrencën pasi operatorët ekonomikë e kanë më të thjeshtë pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël.



Numri total i ofertave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë në procedurat e shpallura me fitues nga Autoritetet Kontraktore për vitin 2017, në Sistemin e Prokurimit Elektronik, është **169,364**.




Gjithashtu për vitin 2017 në Sistemin e Prokurimit Elektronik janë regjistruar **18.337 operatorë ekonomikë** të rinj vendas, të cilët janë regjistruar në SPE, automatikisht pas regjistrimit të tyre në QKB dhe **75** operatorë ekonomikë të huaj, të cilët janë regjistruar direkt në SPE. Rritja e numri të operatorëve ekonomikë të regjistruar rishtazi në SPE, ndikon drejtëpërsëdrejti në rritjen e konkurrencës në procedurat e prokurimit publik.



Problematikë gjatë vitit 2017, ka vazhduar të mbetet numri i lartë procedurave me negociim pa shpallje paraprake (31.8% e totalit të të gjitha procedurave të prokurimit, të zhvilluara gjatë vitit 2017). Megjithatë vlen të theksohet se një numër i konsiderueshëm i rasteve të përdorimit të kësaj procedure (67% e rasteve) është për blerjen e mallrave dhe shërbimeve për mbulimin e nevojave të fillim vitit, dhe vlera e prokuruar nëpërmjet procedurës me negociim pa shpallje paraprake, është shumë më e ulët, krahasuar me vlerën e prokuruar me procedurat e tjera konkurruese (vlera procedurave me negociim pa shpallje paraprake është vetëm 8.3% e të gjithë vlerës totale).

Gjithsesi, duke e njohur problematikën, në fund të vitit 2017 janë marrë masa për të reformuar sistemin në këtë drejtim dhe për të kufizuar në maksimum numrin e procedurave me negociim pa shpallje. Ndër masat kryesore ishte vendosja e detyrimit për zhvillimin në formë elektronike të kësaj lloji procedure nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik, që prej Janarit 2018.

Si rezultat i këtyre masave, numri procedurave me negociim pa shpallje në 3 mujin e parë të vitit 2018, është ulur 10-fish, krahasur me të njëjtën periudhë të vitit 2017. Konkretisht situata paraqitet si më poshtë:



Gjithashtu gjatë vitit 2017, për herë të parë u krijua **Regjistri Kombëtar Online i Parashikimeve të Fondeve Publike** si dhe **Regjistri Kombëtar Online i Realizimeve të Fondeve Publike**.

Automatizimi i këtyre dy regjistrave ka një rëndësi shumë të madhe për rritjen e përgjegjësisë së Autoriteteve Kontraktore në planifikimin e nevojave që do të prokurojnë gjatë vitit në vijim si dhe në rritjen e transparencës në përdorimin dhe mirëmenaxhimin e fondeve publike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

ANALIZA VJETORE 2017



PËRMBAJTJA

SHKURTIME	6
PËRKUFIZIME	7
1. HYRJE	8
1.1. Qëllimi i veprimtarisë së Agjencisë së Prokurimit Publik	9
2. TË DHËNA STATISTIKORE MBI SISTEMIN E PROKURIMIT PUBLIK NË SHQIPËRI	10
2.1. Statistika në lidhje me numrin e procedurave të prokurimit publik, koncesioneve/ppp dhe ankandit publik, të shpallura gjatë vitit 2017	11
2.1. Statistika për procedurat konkurruese të prokurimit, të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik	12
2.1.1. Statistika sipas Tipit të kontratës	12
2.1.2. Statistika sipas Llojit të procedurave	13
2.1.3. Statistika sipas njoftimeve të fituesit	14
2.1.4. Statistika për kontratat e nënshkruara	15
2.1.5. Statistika mbi përqindjen e kursyer nga procedurat e kryera në sistemin elektronik	17
2.2. Të dhëna mbi procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	19
2.3. Marrëveshjet Kuadër	21
2.4. Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël	23
2.5. Statistika në lidhje me numrin e procedurave të dhënies me koncesion/PPP gjatë vitit 2017	24
2.6. Statistika në lidhje me procedurat e ankandit publik të zhvilluara gjatë vitit 2017	24
2.7. Statistika në lidhje me procedurat e krijuara në sistemin elektronik	27
2.8. Statistika në lidhje me autoritetet kontraktore që kanë krijuar procedura në sistemin elektronik	28
2.9. Statistika në lidhje me regjistrat e parashikimeve të krijuara në sistemin e Prokurimit elektronik	31
2.10. Statistika në lidhje me ofertat e krijuara në sistemin elektronik për procedurat e arkivuara	31



3. INICIATIVAT LEGJISLATIVE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2017	34
3.1 Ndryshimet legjislative	34
3.1.1 Ndryshimet në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”	34
3.1.2 Ndryshime në Rregullat e Prokurimit Publik	34
3.1.3 Udhëzime, Rekomandime dhe Njoftime të APP	35
3.1.3.1. Udhëzimet	35
3.1.3.2 Rekomandimet	37
3.1.3.3 Njoftimet	37
3.1.4. Ndryshime në dokumentat standarde të tenderit	39
4. TREGUES TË VEPRIMTARISË KËSHILLUESE DHE PËRFAQËSUESE TË APP GJATË VITIT 2017	40
4.1. Praktikat e shqyrtuara për dhënie mendimesh, këshilla apo udhëzimesh gjatë këtij viti	40
4.2. Shqyrtimi i propozimeve për përjashtimin e operatorëve ekonomikë	41
4.3. Përfaqësimi në proceset gjyqësore	43
5. TREGUES TË VEPRIMTARISË SË MONITORIMIT TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT	47
5.1. Verifikimi i zbatimit të ligjshmërisë	47
5.2. Shqyrtimi i raporteve të organeve audituese	50
5.3. Gjetjet dhe problematikat e evidentuara gjatë procesit të monitorimit	53
5.4. Masat Administrative	57
6. TREGUESIT E VEPRIMTARISË PËR TEKNOLOGJINË E INFORMACIONIT DHE PUBLIKIMIN	60
6.1 Sektori i Publikimeve	60
6.2 Sektori i teknologjisë së informacionit	61
6.2.1 Objektivat e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit	63
6.2.2 Garantimi në kohë dhe me cilësi i ecurisë së punës për të gjithë përdoruesit e Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE) dhe Sistemit të Arkivës Elektronike (SAE).	64
6.2.3. Dhënia e asistencës teknike brenda dhe jashtë APP	65
6.2.4. Krijimi i përdoruesve të rinj për vitin 2017	66
6.2.5. Statistika të tjera në lidhje me përdorimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik	69
6.2.5.1. Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve	69
6.2.5.2 Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas 24 orëve.	70
6.2.5.3. Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas ditëve të javës.	71



6.2.5.4. Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas muajve të vitit.	72
6.2.5.5. Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas qyteteve kryesore.	73
6.2.5.6. Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas shteteve.	73
6.2.5.7. Aktiviteti i përdoruesve sipas ndërfaqeve më të klikuara në portalin e APP.	74
6.2.5.8. Aktiviteti i përdoruesve sipas fjalëve kyc më të përdorura për kërkimin e portalit të APP.	76
6.2.5.9. Aksesimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik sipas shfletuesve dhe sistemeve operative.	77
6.2.5.10. Aksesimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik sipas llojeve të pajisjeve më të përdorura nga përdoruesit	78
6.2.5.11. Aksesimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik sipas sistemeve operative më të përdorur nga përdoruesit	79
7. INTEGRIMI EUROPIAN DHE BASHKËPUNIMI I AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK ME INSTITUCIONE TË TJERA	80
7.1 Integrimi europian	80
7.2. Bashkëpunimi i APP me institucione të huaja	81
7.3. Bashkëpunimi i APP me institucione të tjera në Shqipëri	82
7.4 Asistenca e projekteve të huaja	83
8. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE, DHE FINANCËS	84
8.1 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	84
8.2 Autoriteti Përgjegjës	84
8.3 Aktivitetet në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve administrative të stafit të APP dhe specialistëve të prokurimit publik pranë autoriteteve kontraktore	84
8.3.1 Pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare	84
8.3.2 Trajnimet e punonjësve të prokurimeve pranë Autoriteteve Kontraktore	85
8.4 Gjendja financiare e Agjencisë së Prokurimit Publik për vitin 2017	86
9. PRIORITETET E AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN 2018	88



SHKURTIME

AK - Autoritet Kontraktor

APP - Agjencia e Prokurimit Publik

ASPA - Shkolla Shqiptare e Administratës Publike

ATRAKO - Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve

BB - Banka Botërore

BNJP - Buletini i Njoftimeve Publike

BOE – Bashkim i Operatorëve Ekonomikë

OE - Operator Ekonomik

ILDKPKI - Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit

KVO - Komisioni i Vlerësimit të Ofertave

KPA - Kodi i Procedurave Administrative

KLSH - Kontrolli i Lartë i Shtetit

KM - Këshilli i Ministrave

KPP - Komisioni i Prokurimit Publik

LAP - Ligji për Ankandin Publik

LPP - Ligji i Prokurimit Publik

MK-Marrëveshje Kuadër

NJP- Njësi Prokurimi

OQB - Organi Qendror Blerës

PBB- Produkt i Brendshëm Bruto

PPP - Partneriteti Publik Privat

QKB - Qendra Kombëtare e Biznesit

SA - Strategjia Antikorrupsion.

SAE - Sistemi i Arkivës Elektronike

SMFP - Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike

SPE- Sistemi i Prokurimit Elektronik



PËRKUFIZIME

Në funksion të interpretimit të kësaj analize termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

Fondi limit i prokuruar - Vlera pa TVSH, që përlogaritet nga autoriteti kontraktor në çastin e publikimit të njoftimit të kontratës ose në çastin e fillimit të procedurës së prokurimit, në rastet kur nuk kërkohet një publikim i tillë.

Vlera e fituar – Vlera e ofertës të shpallur fituese dhe e finalizuar me njoftim kontrate të nënshkruar.

Fond i kursyer - Diferenca midis fondit limit të prokuruar dhe vlerës së fituar

Procedurë e fituar elektronike - Procedurë prokurimi e zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik, e cila është finalizuar me njoftim fituesi.

Procedurë prokurimi me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës – Lloj procedure e cila përdoret në rrethana të vecanta të parashikuara nga legjislacioni i prokurimit publik.

Shtesë kontrate me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës- Lloj procedure prokurimi, me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, bazuar mbi një kontratë ekzistuese të lidhur nëpërmjet një procedure të mëparshme prokurimi konkurruese, në një vlerë deri në 20% të vlerës së përgjithshme të kontratës fillestare.

Procedura të reja me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës – Procedura prokurimi me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, që ndiqen nga Autoriteti Kontraktor në një nga situatat e parashikuara nga LPP, përveç rasteve të shtesave të kontratave.

Procedura të papërfunduara (anulluara) - Procedura prokurimi që nuk janë finalizuar me njoftim fituesi

Prokurime elektronike - Procedurat e prokurimit që zhvillohen nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik.

Pezullim - Ndërprerje e zhvillimit të procedurës së prokurimit në rastet kur ka ankesa në Autoritetin Kontraktor apo në Komisionin e Prokurimit Publik.




1. HYRJE

Ky raport pasqyron punën e Agjencisë së Prokurimit Publik (këtu e në vijim “APP”) dhe funksionimin e sistemit të prokurimit publik për periudhën nga 1 Janar 2017 deri në 31 Dhjetor 2017.

APP e ushtron veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit Nr. 9643/2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 125/2013 “Për konçesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9874/2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar si dhe në bazë të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 143, datë 06.07.2010 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Mbështetur në nenin 13 të ligjit për prokurimin publik “APP është organ qendror, person juridik publik në varësi të Kryeministrit, që financohet nga Buxheti i Shtetit” dhe funksionon sipas organigramës së mëposhtme.



Raporti paraqet në mënyrë të detajuar edhe të dhëna statistikore në lidhje me funksionimin e sistemit të prokurimit publik në përgjithësi përfshirë sistemin elektronik të prokurimit.



1.1. Qëllimi i veprimtarisë së Agjencisë së Prokurimit Publik

Qëllimi kryesor i punës së Agjencisë së Prokurimit Publik është garantimi i mirëfunksionimit të sistemit të prokurimit publik në Shqipëri duke u fokusuar në drejtimit e mëposhtme:

- Përmirësimi i vazhdueshëm i legjislacionit;
- Monitorimi i vazhdueshëm i procedurave të prokurimit të zhvilluara nga autoritetet kontraktore;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i Sistemit elektronik të Prokurimit;
- Ngritja e kapaciteteve në fushën e prokurimit në Autoritetet Kontraktore;
- Dhënia e asistencës së vazhdueshme për Autoritetet Kontraktore;
- Rritja e efikasitetit të prokurimit publik.

Për sa më sipër, viti 2017 ka paraqitur një sërë sfidash të rëndësishme duke pasur parasysh edhe fokusin që i është dhënë kësaj fushe nga ana e Qeverisë shqiptare dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Në këtë kuptim, APP ka punuar për ndryshimin e ligjit të prokurimit sidomos sa i takon sistemit të rishikimit dhe garantimit të pavarësisë së Komisionit të Prokurimit Publik duke e vendosur këtë institucion në varësi të Kuvendit.

Gjithashtu, është punuar edhe për përmirësimin e akteve nënligjore në fushën e prokurimit me qëllim eliminimin e përdorimit të procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, rritjen e përdorimit të Marrëveshjeve Kuadër, rritjen e transparencës dhe uljen e burokracive në kryerjen e procedurave të prokurimit nga ana e autoriteteve kontraktore.

Një rol të veçantë në drejtim të garantimit të mirëfunksionimit të sistemit të prokurimit ka edhe monitorimi i procedurave të prokurimit me qëllim identifikimin e problematikave në lidhje me implementimin e dispozitave ligjore nga ana e autoriteteve kontraktore sidomos sa i takon zhvillimit të procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.

Prokurimi elektronik është gjithashtu një element shumë i rëndësishëm i sistemit të prokurimit në Shqipëri, i cili përbën një nga mjetet kryesore për garantimin e transparencës në zhvillimin e procedurave të prokurimit.

Për këtë arsye, edhe gjatë vitit 2017 i është kushtuar një vëmendje e veçantë implementimit të funksionaliteteve të reja të sistemit elektronik sidomos regjistrimit elektronik të parashikimeve dhe të realizimeve me qëllim familjarizimin e Autoriteteve kontraktore me këto funksionalitete të cilat nga viti 2018 do të jenë të detyrueshme për zbatim.

Duke pasur parasysh edhe problematikën e hasura në përdorimin e procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, të konstatuara vazhdimisht jo vetëm nga APP, por edhe nga institucione të tjera vendase apo të huaja si KLSH, Banka Botërore, Komisioni Europian etj, është krijuar edhe një modul i ri në sistemin e prokurimit elektronik.

Nëpërmjet këtij moduli mundësohet zhvillimi i kësaj lloji procedure në mënyrë elektronike duke mundësuar monitorimin në mënyrë të vazhdueshme nga APP dhe, njëkohësisht, rritjen e transparencës.

Nga ana tjetër, mirëfunksionimi i sistemit të prokurimit lidhet ngushtësisht me nivelin e njohurive dhe përgatitjes së autoriteteve kontraktore dhe punonjësve të tyre që merren me zhvillimin e procedurave të prokurimit.

Në këtë kuadër, APP ka vijuar bashkëpunimin me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) për realizimin e këtyre trajnimit të autoriteteve kontraktore.



2. Të dhëna Statistike mbi sistemin e prokurimit publik në Shqipëri

Prokurimi publik është një nga fushat kryesore të veprimtarisë shtetërore dhe një nga proceset më të rëndësishme në menaxhimin e financave publike. Sikundër tregohet edhe nga shifrat dhe të dhënat e përpunuara në këtë kuadër, fondi buxhetor i shpenzuar për prokurime publike shkon mesatarisht nga 5-12% të Prodhimit të Brendshëm Bruto.

Kështu, nga të dhënat e fundit të raportuara dhe të disponueshme, për vitin 2015, në qeveritë e shteteve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) prokurimet publike zenë mesatarisht 12% të PBB-së. Në rajon (Bosnje Hercegovina, Mali i Zi, Serbi, Maqedoni), vlerat e këtij raporti variojnë nga 5% deri në 12%¹.

Ndërkohë, përsa i përket Shqipërisë, bazuar në të dhënat e siguruar nga INSTAT mbi Produktin e Brendshëm Bruto (PBB), rezultojnë se, për vitin 2017, fondi total limit i prokuruar zë 7% të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB).


Tabela dhe grafiku i mëposhtëm paraqesin të dhënat në lidhje me raportin fond total limit i prokuruar-PBB:

Tabela 1

Treguesi makroekonomik	Vlera (në miliardë Lekë)
PBB- Produkti Brendshëm Bruto	1,555,200,000,000
Fondi total limit i prokuruar në Republikën e Shqipërisë	109,619,600,197
Fondi total limit i prokuruar në Republikën e Shqipërisë në raport me PBB (në %)	7%

Grafiku 1

Raporti Fondi Total Limit i Prokuruar-PBB



1. Riinvestinstitute.org, 2017. <http://www.riinvestinstitute.org/Al/riinvest-story/243/cila-eshte-vlera-e-prokurimit-publik-ne-ekonomine-kosovare/> (Konsultimi i fundit 01.03.2018)



2.1. Statistika në lidhje me numrin e procedurave të prokurimit publik, koncesioneve/ppp dhe ankandit publik, të shpallura gjatë vitit 2017

Në këtë seksion paraqiten të dhënat e detajuara lidhur me procedurat e prokurimit, përfshirë procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe procedurat me vlerë të vogël, të zhvilluara në Republikën e Shqipërisë gjatë vitit 2017.

Në mënyrë të përmbledhur, të dhënat kryesore për prokurimin elektronik dhe procedurat negociim pa shpallje paraprake të njoftimit si dhe raportet në përqindje dhe fondi i kursyer në total, për vitin 2017, paraqiten si më poshtë:

Tabela 2

Prokurime elektronike dhe Procedura me Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit për Periudhën Janar-Dhjetor 2017	
Numri Total i Procedurave të publikuara elektronike	7317
Fondi total limit i prokuruar për procedurat e publikuara elektronike (vlera në lekë)	109,619,600,197
Numri Total i Procedurave të fituara elektronike	4790
Fondi total limit i prokuruar i procedurave të fituara elektronike (vlera në lekë)	91,765,890,297
Vlera totale e fituar e procedurave të fituara elektronike (vlera në lekë)	83,573,122,421
Nr.Total i Procedurave me Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	2234
Fondi total limit i prokuruar për procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës (vlera në lekë)	7,621,305,643
Vlera totale e fituar për procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës (vlera në lekë)	7,576,769,448
% që zë nr i procedurave me negociim pa shpallje ndaj nr total të procedurave të fituara (elektronik+negocim pa shpallje)	31.8%
% që zë fondi limit i prokuruar për procedurat me negociim pa shpallje ndaj fondit total limit të prokuruar për procedurat e fituara (elektronik+negocim pa shpallje)	7.7%
% që zë vlera e fituar për procedurat me negociim pa shpallje ndaj vlerës totale të fituar për procedurat e fituara (elektronik+negocim pa shpallje)	8.3%
Numri Total i Procedurave të fituara (elektronik+negocim pa shpallje)	7024
Fondi total limit i prokuruar i procedurave të fituara (elektronik+negocim pa shpallje) (vlera në lekë)	99,387,195,940
Vlera totale e fituar i procedurave të fituara (elektronik+negocim pa shpallje)	91,149,891,869
% që zë Vlera totale e fituar ndaj Fondit total limit të prokuruar	91.7%
Fondi total i kursyer (vlera në lekë)	8,237,304,071
% që zë Fondi i total i kursyer ndaj Fondit total limit të prokuruar	8.3%



Sikurse vërehet nga tabela e mësipërme, numri total i procedurave të shpallura në sistemin elektronik të prokurimit për vitin 2017 është **7317**, ndërkohë që vetëm **4790** prej tyre kanë përfunduar me fitues.

Sa i takon numrit të procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, për vitin 2017 janë zhvilluar gjithsej **2234** të tilla, të cilat përbëjnë **31.8%** të numrit total të procedurave të fituara (elektronike+negocime pa shpallje).

Ndërkohë, sikurse do të detajohet në vijim të kësaj analize, nga 2234 procedura me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës **vetëm 742 janë procedura të reja**, ndërsa 1492 janë shtesa kontrate.

Gjithsesi, sikundër rezulton edhe nga Tabela nr.2, fondi limit i prokuruar me këtë lloj procedure (**7,621,305,643 lekë**) është shumë më i ulët, krahasuar me fondin limit total të prokuruar në procedurat elektronike konkurruese (**109,619,600,197 lekë**).

Po kështu, sa i takon raportit të mësipërm për vlerën e fituar, vlera e fituar për procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ze **8.3% të vlerës totale të fituar** për procedurat e fituara (elektronike+negocime pa shpallje).

2.1. Statistika për procedurat konkurruese të prokurimit, të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik

Në këtë pjesë të analizës vjetore do të pasqyrohen dhe interpretohen të dhënat mbi numrin e procedurave të prokurimit publik mbi vlerën 800.000 mijë lekë, të cilat janë shpallur për t'u zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik.

Gjithashtu, në këtë pjesë do të pasqyrohen dhe të dhënat respektive për numrin e njoftimeve të fituesve dhe numrin e njoftimeve të kontratave të nënshkuara.

2.1.1. Statistika sipas Tipit të kontratës

Numri total i njoftimeve të kontratave të procedurave të prokurimit të publikuara gjatë vitit 2017 në sistemin e prokurimit elektronik, sipas tipit të kontratës, shërbim, mall, punë, në faqen zyrtare të APP është **7,317** (2,208 më shumë se në vitin 2016).

Siç vërehet nga të dhënat e përpunuara, numrin më të madh të procedurave të shpallura e zenë procedurat për prokurimin e mallrave me **3899** procedura të shpallura në total ose **53%** të procedurave të shpallura (1392 më shumë se në vitin 2016), duke vijuar me procedurat për prokurimin e shërbimeve (**2098** ose 698 më shumë se në vitin 2016) dhe të punëve civile (**1320** ose 134 më shumë se në vitin 2016).

Tabela 3

Njoftime Procedurash Janar-Dhjetor 2017					
Shërbime		Mallra		Punë Civile	
Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave
Shërbim Konsulencë dhe Konkurs Projektimi	137	Shërbim Konsulencë dhe Konkurs Projektimi	—	Shërbim Konsulencë dhe Konkurs Projektimi	—
E hapur Ndërkombëtare	11	E hapur Ndërkombëtare	17	E hapur Ndërkombëtare	1
Procedurë e hapur lokale	739	Procedurë e hapur lokale	909	Procedurë e hapur lokale	675
Kërkesë për Propozim	1211	Kërkesë për Propozim	2973	Kërkesë për Propozim	664
TOTALI	2098	TOTALI	3899	TOTALI	1320



2.1.2. Statistika sipas llojit të procedurave

Në formë tabelore, të dhënat për numrin e procedurave të prokurimit publik, të ndara sipas llojit të procedurës, të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik për vitin 2017, dhe fondet limite përkatëse, janë si më poshtë:

Tabela 4

Numri total i procedurave të shpallura të ndarë sipas llojit të procedurave për Periudhën Janar-Dhjetor 2017	
Numri Total i Procedurave të shpallura	7317
Fondi total limit i prokuruar i procedurave të shpallura (lekë)	109,619,600,197
Numri i procedurave Shërbim konsulence dhe konkurs projektimi	137
Fondi limit i prokuruar për procedurat Shërbim konsulence dhe konkurs projektimi (vlera në lekë)	1,646,293,649
Numri i procedurave e hapur ndërkombëtare	29
Fondi limit i prokuruar në procedurat e hapura ndërkombëtare (vlera në lekë)	11,150,343,791
Numri i procedurave e hapur lokal	2,323
Fondi limit i prokuruar për procedurat e hapura lokale (vlera në lekë)	86,473,454,498
Numri i procedurave Kërkesë për propozim	4,828
Fondi limit i prokuruar për procedurat Kërkesë për propozim (vlera në lekë)	10,349,508,259

Nga analizimi i të dhënave sa i takon fondit limit, rezulton se vlera totale e fondit limit të shpallur në vitin 2017 është **109,619,600,197 lekë** në total ose **1,388,862,508 lekë** më e lartë se në vitin 2016.

Ndërkohë, sa i takon llojit të procedurave të zhvilluara, sikundër vërehet edhe nga tabela e mësipërme dhe grafiku nr.2 numrin më të madh të procedurave e ze procedura “kërkesë për propozim” me **4828** procedura të shpallura ose **66%** të numrit total të procedurave të shpallura.

Grafiku i mëposhtëm paraqet, numrin e procedurave të prokurimit publik, të ndara sipas llojit të procedurës, të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik për vitin 2017:

Grafiku 2





2.1. 3. Statistika sipas njoftimeve të fituesit

Numri total i njoftimeve të fituesit të procedurave të prokurimit të publikuara gjatë vitit 2017 në sistemin e prokurimit elektronik, sipas tipit të kontratave, shërbim, mall, punë, është **4790** (277 më pak se në vitin 2016).

Në formë tabelore, të dhënat për procedurat e prokurimit elektronik, të ndara sipas tipit të kontratës të zhvilluara dhe të përfunduara me fitues në sistem gjatë vitit 2017 janë si më poshtë:

Tabela 5

Njoftime Fituesish Janar-Dhjetor 2017					
Shërbime		Mallra		Punë Civile	
Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave
E hapur Ndërkombëtare	4	E hapur Ndërkombëtare	15	E hapur Ndërkombëtare	1
Procedurë e hapur lokale	380	Procedurë e hapur lokale	723	Procedurë e hapur lokale	624
Kërkesë për Propozim	743	Kërkesë për Propozim	1738	Kërkesë për Propozim	479
Shërbim Konsulencë dhe Konkurs Projektimi	83	Shërbim Konsulencë dhe Konkurs Projektimi	—	Shërbim Konsulencë dhe Konkurs Projektimi	—
TOTALI	1210	TOTALI	2476	TOTALI	1104

Ndërkohë, njoftimet e fituesit sipas llojit të procedurës, fondit litmit të prokuruar dhe vlerës së fituar për procedurat paraqiten si më poshtë:


Tabela 6

Të dhëna për procedurat e prokurimit të zhvilluara dhe të përfunduara me fitues Janar-Dhjetor 2017						
Llojet e procedurave	Numri Total i procedurave	Fondi limit total i prokuruar (vlera në lekë)	Vlera totale e fituar (vlera në lekë)	% që zë Fondi i ofruar ndaj Fondit limit të prokuruar	Fondi total i kursyer (vlera në lekë)	% që zë Fondi i kursyer ndaj Fondit limit të prokuruar
Procedurë e hapur ndërkombëtare (njoftim fituesi)	20	8,706,913,422	8,176,023,820.00	94	530,889,602	6
Procedurë e hapur lokal (njoftim fituesi)	1727	74,105,768,807	67,288,801,211.00	90.8	6,816,967,596	9.2
Kërkesë për propozim (njoftim fituesi)	2960	7,550,588,691	6,776,768,640.00	89.8	773,820,051	10.2
Shërbim konsulencë, konkurs projektimi (njoftim fituesi)	83	1,402,619,377	1,331,528,750.00	95	71,090,627	5
Totali	4790	91,765,890,297	83,573,122,421.00	91.1	8,192,767,876	8.9



Grafiku i mëposhtëm paraqet, numrin e njoftimeve të fituesve në procedurat e prokurimit publik, të ndara sipas llojit të procedurës, të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik për vitin 2017:

Grafiku 3



2.1.4. Statistika për kontratat e nënshkruara

Numri total i njoftimeve të kontratave të nënshkruara të procedurave të prokurimit të zhvilluara gjatë vitit 2017 në sistemin e prokurimit elektronik, sipas tipit të kontratave, shërbim, mall, punë, në faqen zyrtare të APP është **4749**.

Njoftimet e kontratave të nënshkruara sipas llojit të procedurave dhe tipit të kontratave paraqiten si më poshtë:

Tabela 7

Njoftime Kontratash të nënshkruara Janar-Dhjetor 2017					
Shërbime		Mallra		Punë Civile	
Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave
Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	87	Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	—	Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	—
E hapur Ndërkombëtare	11	E hapur Ndërkombëtare	19	E hapur Ndërkombëtare	1
Procedurë e hapur lokale	370	Procedurë e hapur lokale	728	Procedurë e hapur lokale	636
Kërkesë për Propozim	722	Kërkesë për Propozim	1,693	Kërkesë për Propozim	482
TOTALI	1,190	TOTALI	2,440	TOTALI	1,119



Tabela 8

Të dhëna për kontratat e nënshkruara Janar-Dhjetor 2017						
Llojet e procedurave	Nr. Total i procedurave	Fondi limit total i prokuruar (Vlera në lekë pa TVSH)	Vlera totale e fituar (Vlera në lekë pa TVSH)	% që zë Vlera totale e fituar ndaj Fondit limit të prokuruar	Fondi total i kursyer (Vlera në lekë pa TVSH)	% që zë Fondi i kursyer ndaj Fondit limit të prokuruar
Procedurë e hapur ndërkombëtare (kontrata të nënshkruara)	31	9,012,964,609	8,402,046,326	93,2	610,918,283	6,8
Procedurë e hapur lokal (kontrata të nënshkruara)	1734	75,418,424,237	68,592,754,762	90,9	6,825,669,475	9,1
Kërkesë për propozim (kontrata të nënshkruara)	2897	7,376,339,086	6,713,123,322	91	663,215,764	9
Shërbim konsulence, konkurs projektimi (kontrata të nënshkruara)	87	1,374,859,260	1,322,550,062	96,2	52,309,198	3,8
TOTALI	4749	93,182,587,192	85,030,474,472	91,3	8,152,112,720	8,7

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelat e mësipërme, rezulton se numri total i procedurave të shpallura në sistemin e prokurimit elektronik dhe që kanë vijuar është **4889**, ndërkohë që numri i procedurave të fituara (të cilat maten me njoftimet e fituesve të publikuar në sistem) është **4,790**.

Diferenca midis numrit të procedurave të shpallura me ato të përfunduara me njoftim fituesi në sistem, shpjegohet me faktin se disa nga procedurat e shpallura janë anuluar (për arsye të ndryshme të cilat do të analizohen më poshtë), ose janë procedura të cilat janë shpallur në fund të vitit 2017 dhe nuk kanë përfunduar me njoftimin e fituesit deri më 31 Dhjetor 2017 (kanë qenë në proces).

Gjithashtu, po nga tabelat e mësipërme rezulton se numri i kontratave të nënshkruara, **4749** në total, është më i vogël se numri i njoftimeve të fituesve **4,790** (diferenca midis numrit të fituesve me kontrata të nënshkruara është 41). Kjo diferencë shpjegohet me argumentin se afati kohor nga momenti i shpalljes së fituesit deri në lidhjen e kontratës është 60 ditë.

Në këtë kuptim deri më 31 Dhjetor 2017, kur janë analizuar të dhënat e mësipërme, 41 objektet e prokurimit mund të kenë qenë brenda afateve të përcaktuara për lidhjen e kontratave.

Si ilustrim për këtë situatë shërben rasti i procedurave të Hapura Ndërkombëtare, ku numri i kontratave të nënshkruara (31) është më i madh se numri i fituesve (20). Diferenca në kontratat e nënshkruara shpjegohet me faktin se 13 prej kontratave të nënshkruara janë procedura të zhvilluara në vitin 2016, ndërsa për dy prej fituesve të shpallura në vitin 2017, kontratat kanë qenë në proces për nënshkrim në vitin 2018.



Grafiku i mëposhtëm paraqet, numrin e njoftimeve të lidhjes së kontratave në procedurat e prokurimit publik, të ndara sipas tipit të kontratës, të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik për vitin 2017:

Grafiku 4



2.1.5. Statistika mbi përqindjen e kursyer nga procedurat e kryera në sistemin elektronik

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen të dhënat për numrin e procedurave të prokurimit publik të zhvilluara në sistemin elektronik gjatë vitit 2017, fondin limit përkatës, numrin e procedurave të fituara me fondin limit dhe fondin e ofruar përkatës, si dhe kursimin në përqindje.

Tabela 9

Procedura prokurimi të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik në periudhën Janar-Dhjetor 2017	
Numri Total i procedurave të publikuara	7317
Fondi total limit i prokuruar i procedurave të publikuara (vlera në lekë)	109,619,600,197
Numri Total i procedurave të cilat kanë vazhduar	4889
Fondi total limit i prokuruar i procedurave të cilat kanë vazhduar (vlera në lekë)	89,309,902,865
Numri Total i procedurave të papërfundura (anulluar, etj)	2428
Fondi total limit i prokuruar i procedurave të papërfundura (anulluar, etj) (vlera në lekë)	20,309,697,332
Numri Total i Procedurave të fituara	4790



Procedura prokurimi të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik në periudhën Janar-Dhjetor 2017	
Fondi total limit i prokuruar për procedurat e fituara (vlera në lekë)	91,765,890,297
Vlera totale e fituar (vlera në lekë)	83,573,122,421
% që zë Vlera totale e fituar ndaj Fondit total limit të prokuruar	91.1%
Fondi total i kursyer (vlera në lekë)	8,192,767,876
% që zë Fondi i kursyer ndaj Fondit total limit të prokuruar	8.9%

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën më sipër, rezulton se nga **7317** procedurat e shpallura për t'u zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik, **2428** prej tyre janë anuluar, shifër e cila është dukshëm më e madhe se në vitin 2016 ku numri total i procedurave të anuluar ishte vetëm **493**.

Për të kuptuar dhe analizuar drejt këtë shifër (e cila në pamje të parë është relativisht e lartë, po të kemi në konsideratë numrin total të procedurave të shpallura), duhet të mbajmë parasysh se, duke qenë se këto procedura zhvillohen në formë elektronike, ka dy arsye kryesore anulimi: i) arsye teknike; dhe ii) arsye ligjore.

Ndër arsyet teknike përmendim Gabimet teknike njerëzore të kryera në sistemin elektronik të prokurimit.

Ndër arsyet ligjore që çojnë në anulimin e procedurave përmendim vendimet e anulimit nga Komisioni i Prokurimit Publik, mungesë konkurrence gjatë zhvillimit të procedurave, anulimeve për shkak të mbylljes së vitit buxhetor, etj.

Një rast tjetër që vlen të përmendet në funksion të analizës së anulimeve është dhe rasti kur procedurat shpallen me lote. Sipas të dhënave, numri më i madh i anulimeve (**1400** procedura) i takon procedurave të prokurimit të shpallura me lote.

Mbi **80%** të anulimeve të procedurave me lote i takojnë procedurave për blerje të medikamenteve dhe materialeve të shërbimit shëndetësor, ku kryesisht janë anuluar ato lote që prokurohen për sasi me vlera të vogla të medikamenteve.

Ndër arsyet e anulimit të procedurave përmendim edhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 482, datë 05.07.2017, "Për pezullimin e përkohshëm të procedurave të prokurimit për vitin 2017", i cili pezulloi procedurat në periudhën Korrik-Tetor 2017, duke bërë që një pjesë e procedurave të mos përfundojnë brenda afatit.

Një tregues tjetër që duhet të analizohet nga tabela e mësipërme është diferenca e fondit limit të prokuruar dhe numrit të procedurave që janë zhvilluar në vitin 2017 (4889 procedura me fond limit **89,309,902,865 leke**) me fondit limit të prokuruar dhe numrin e procedurave të përfunduara me njoftim fituesi në vitin 2017 (4790 procedura me fond limit **91,765,890,297 leke**).

Sikundër duket edhe nga shifrat, vlera e fondit limit për procedurat me njoftim fituesi është më e madhe se vlera e fondit të procedurave që kanë vijuar në sistem megjithëse, në numër, njoftimet e fituesit janë më pak se procedurat që kanë vijuar.



Kjo diferencë në vlerat e fondeve respektive vjen për faktin se në numrin e procedurave të përfunduara me njoftim fituesi përfshihen dhe ato procedura që kanë filluar në vitin 2016, por njoftimi i fituesit është shpallur në vitin 2017.

2.2. Të dhëna mbi procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës

Përveç procedurave konkurruese të prokurimit publik të shpallura për t'u zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik, sipas legjislacionit të prokurimit publik në fuqi, autoritetet kontraktore, nëse ndodhen në kushtet e parashikuara nga ligji, mund të kryejnë dhe procedura prokurimi me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.

Gjithsesi, sikundër rezulton edhe nga shifrat e paraqitura numri i këtyre lloj procedurash është relativisht i lartë gjë që vjen si rezultat i një sërë faktorësh që detyrojnë autoritetet kontraktore të përdorin këtë lloj procedure për plotësimin e nevojave të tyre, të cilat mund të renditen si më poshtë:

- Përdorimi i procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës për plotësimin e nevojave të fillim vitit:

Ky rast i përdorimit të kësaj lloj procedure është parashikuar si një mënyrë për t'u ardhur në ndihmë autoriteteve kontraktore, të cilat, për shkak të parashikimeve të ngurta të legjislacionit për zbatimin e buxhetit në lidhje me kërkesën për verifikimin e disponueshmërisë së fondeve në thesar dhe vonesave në alokimin e fondeve të miratuara buxhetore, në fillim të vitit kalendarik gjenden në pamundësi për plotësimin e nevojave të tyre me mallra apo shërbime të domosdoshme deri në mundësimin e zhvillimit të procedurave konkurruese.

Në fakt, sikundër vërehet edhe nga shifrat e paraqitura më poshtë, numri më i madh i këtyre lloj procedurave kryhet pikërisht gjatë tremujorit të parë të vitit (1611 procedura ose **72%** nga 2234 në total).

Të dhënat për procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake, për vitin 2017 paraqiten si më poshtë:

Tabela 10

Procedura me Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës për Periudhën Janar-Dhjetor 2017	
Numri Total i Procedurave të fituara elektronike	4,790
Fondi total i prokuruar i procedurave të fituara elektronike	83,573,122,421
Numri Total i Procedurave të fituara Negocim pa shpallje	2,234
Vlera totale e fituar negociim pa shpallje	7,576,769,448
% që zë nr i procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ndaj nr total të procedurave të fituara (elektronik+negocim pa shpallje)	31.8%
% që zë vlera e fituar për procedurat me negociim pa shpallje ndaj fondit total (elektronik+negocim pa shpallje) për procedurat e fituara	8.3%
Numri Total i Procedurave të fituara (elektronik+negocim pa shpallje)	7,024



Procedura me Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës për Periudhën Janar-Dhjetor 2017	
Vlera totale e fituar e procedurave të fituara (elektronik+negocim pa shpallje)	91,149,891,869
Numri Total i Procedurave të Reja me Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	742
Vlera totale e fituar e Procedurave të Reja me Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	3,557,781,894
% që zë nr i Procedurave të Reja me negocim pa shpallje ndaj nr total të procedurave të fituara (elektronik+negocim pa shpallje)	10.6%
% që zë vlera totale e fituar e Procedurave të Reja me negocim pa shpallje ndaj vlerës totale të fituar (elektronik+negocim pa shpallje)	3.9%
Numri Total i Shtesave të Kontratave me Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	1492
Vlera e fituar për Shtesat e Kontratave me Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	4,018,987,554
% që zë nr i Shtesave të Kontratave me negocim pa shpallje ndaj nr total të procedurave të fituara (elektronik+negocim pa shpallje)	21.2%
% që zë vlera e fituar e Shtesave të Kontratave me negocim pa shpallje ndaj vlerës totale të fituar (elektronik+negocim pa shpallje)	4.4%

Sikurse shihet dhe nga tabela 10, gjatë vitit 2017 janë zhvilluar në total **2,234** procedura me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.

Nga ana tjetër, për herë të parë gjatë vitit 2017 ka qenë e mundur të përcaktohet saktësisht numri i shtesave të kontratave ekzistuese të finalizuara nëpërmjet përdorimit të kësaj lloji procedure. Kështu, sikurse rezulton edhe nga tabela, numri total i **shtesave të kontratave** të nënshkruara gjatë vitit 2017 është **1492** ose 67% e procedurave me negocim pa shpallje të zhvilluara në total dhe vetëm **742** procedura me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës janë **procedura të reja**.

Duhet theksuar që, për sa i përket negocimeve për shtesa kontrate, për këto procedura ekziston tashmë një kontratë e mëparshme e cila është lidhur nëpërmjet një procedure konkurruese. Gjithash-tu, sikurse tregojnë edhe shifrat e paraqitura në tabelën nr. 11 më poshtë shumica e shtesave të kontratave i referohen shtesave për përmbushjen e nevojave të fillimvitit dhe janë kryer gjatë tremujorit të parë të vitit.

Sa i takon raportit të këtyre procedurave me numrin total të procedurave të fituara (elektronik+negocime pa shpallje), procedurat me negocim pa shpallje paraprake sikundër është paraqitur edhe në tabelat e mëparshme zenë në total **31.8%**, ndërkohë që procedurat e reja të finalizuara nëpërmjet kësaj lloji procedure përbëjnë vetëm **10.6%**.

Një ndryshim shumë i madh vihet re në raportin ndërmjet vlerës totale të fituar me negocim pa shpallje ndaj vlerës totale të fituar (elektronik+negocim pa shpallje), e cila përbën **8.3%** të kësaj të fundit, ndërkohë që vlera e fituar për procedurat e reja ze vetëm **3.9%** të vlerës totale të fituar.

Statistika përmbledhëse në lidhje me numrin e kontratave të nënshkruara sipas procedurave me negocim pa shpallje paraprake të realizuara sipas muajve paraqitet si më poshtë:



Tabela 11

Njoftime kontratash të nënshkruara për procedurat me negociim pa shpallje paraprake	
Muaji	Numri i procedurave
Janar	1012
Shkurt	395
Mars	204
Prill	88
Maj	82
Qershor	73
Korrik	38
Gusht	44
Shtator	61
Tetor	62
Nëntor	70
Dhjetor	105
TOTAL VITI 2017	2234

2.3. Marrëveshjet Kuadër

Edhe gjatë këtij viti, nga analizimi i të dhënave rezulton se autoritetet kontraktore kanë vazhduar të përdorin Marrëveshjen Kuadër, të fokusuar kryesisht në shërbimin e blerjes së biletave të udhëtimeve, konsulence, shërbime shëndetësore, apo riparime automjete e paisje.

Në muajin Dhjetor 2017 autoritetet kontraktore filluan me përdorimin e Marrëveshjeve Kuadër, të fokusuar në shërbimin e Ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private.

Këto të dhëna janë një tregues konkret i punës dhe iniciativave të APP për të stimuluar përdorimin e Marrëveshjes Kuadër, si një instrument i rëndësishëm për përmbushjen e nevojave të vazhdueshme të autoriteteve kontraktore nëpërmjet procedurave transparente dhe konkurruese.



Konkretisht, të dhënat në lidhje me përdorimin e këtij instrumenti, paraqiten si më poshtë:

Tabela 12

Marrëveshje Kuadër Janar-Dhjetor 2017		
Lloji i procedurës	Numër	Fondi total Limit i prokuruar
I Hapur Lokal	21	492,712,768
Kërkesë për Propozim	38	154,775,619
Sherbim Konsulence	2	132,816,560
Totali	61	780,304,947

Tabela 13

Njoftime Marrëveshje Kuadër Janar-Dhjetor 2017 të nënshkurara				
	Numër	Fondi total limit i prokuruar (vlera në lekë)	Vlera totale e fituar (vlera në lekë)	Fondi total i kursyer (vlera në lekë)
I Hapur Lokal	13	373,587,372	352,728,602	20,858,770
Kërkesë për Propozim	21	88,213,094	88,204,866	8,228
Sherbim Konsulence	3	132,816,560	113,596,900	19,219,660
Totali	36	594,617,026	554,530,368	40,086,658

Tabela 14

Marrëveshje Kuadër Minikontrata Janar-Dhjetor 2017		
	Nr	Vlera e kontratës
Totali	453	205,571,021



2.4. Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël

Gjatë vitit 2017, kufiri i prokurimeve me vlerë të vogël ka vazhduar të jetë 800.000 mijë lekë.

Sikurse është parashikuar në udhëzimin përkatës të APP, autoritetet kontraktore kanë zbatuar procedurën duke ftuar për të marrë shërbimin/mallin/punën, vetëm pesë operatorët ekonomikë të renditur të parët.

Numri i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara gjatë vitit 2017 dhe fondet përkatëse, paraqiten si më poshtë:

Tabela 15

Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël Janar-Dhjetor 2017	
Numri Total i procedurave të Prokurimit me Vlerë të Vogël	23918
Fondi total limit i prokuruar për procedurat e prokurimit me Vlerë të Vogël (vlera në lekë)	6,345,343,813
Numri Total i Procedurave të papërfundura (anulluar, etj)	8479
Numri Total i procedurave të Prokurimit me Vlerë të Vogël të cilat kanë vazhduar	15439
Fondi total Limit i prokuruar për procedurat e prokurimit me Vlerë të Vogël të përfunduara me njoftim fituesi (vlera në lekë)	3,634,587,211
Vlera totale e fituar në procedurat e prokurimit me Vlerë të Vogël të përfunduara me njoftim fituesi (vlera në lekë)	2,974,908,220
% që zë vlere totale e fituar ndaj Fondit total limit të prokuruar	81.80%
Fondi total i kursyer (vlere në lekë)	659,678,991
% që zë Fondi total i kursyer ndaj Fondit total limit të prokuruar	18.20%

Po të krahasojmë numrin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara në vitin 2017 (**23,918**), me numrin e tyre në vitin 2016 (**19,828**), rezulton se gjatë vitit 2017 në numër janë zhvilluar më shumë procedura.

Ndërkohë që, po të krahasojmë vlerat respektive, rezulton se fondi i prokuruar me këtë lloj procedure gjatë vitit 2017 (**6,345,343,813**), është më i vogël se fondi i prokuruar në vitin 2016 (**10,261,006,899**).

Një tregues tjetër shumë i rëndësishëm që rezulton nga të dhënat në tabelë, është diferenca midis fondit me të cilin janë shpallur procedurat me fondin me të cilin janë fituar ato dhe konkretisht kur-simi është **18.2%**.



Nga krahasimi i të dhënave të vitit 2017 dhe atyre respektive të vitit 2016, rezulton se numri i procedurave me vlerë të vogël të anuluar në vitin 2017 (**8479**) është shumë më i madh, krahasuar me ato të anuluar në vitin 2016 (**2607**).

Ky tregues është ndikuar nga një sërë faktorësh, ku më i theksuar është anulimi nga autoritetet kontraktore për arsye të mos përzgjedhjes së fituesit ndër 5 operatorët ekonomikë të klasifikuar të parët (pra 5 ofertat më të ulëta).

2.5. Statistika në lidhje me numrin e procedurave të dhënies me koncesion/PPP gjatë vitit 2017

Numri i procedurave për dhënien me koncesion/PPP, të shpallura për t'u zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik, njoftimet e fituesit dhe njoftimet e kontratave të nënshkruara, të dërguara gjatë vitit 2017, paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela 16

Procedura për dhënien me koncesion /PPP	Numri i procedurave
Njoftime Kontratash	25
Njoftime Fituesish	15
Njoftime Kontratash të Nënshkruara	2

Në analizimin e të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme, duhet mbajtur në konsideratë fakti që njoftimet e fituesit dhe njoftimet e kontratave të procedurave koncesionare/PPP, nuk i referohen vetëm procedurave të shpallura për t'u zhvilluar në 2017, por një prej tyre është njoftim që lidhet me një procedurë të shpallur në vitin 2016.

Diferenca ndërmjet procedurave për dhënien me koncesion/PPP, të shpallura për t'u zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik me njoftimet e fituesit është për faktin se këto procedura kërkojnë kohë të gjatë në lidhje me vlerësimin e ofertave dhe shpalljen e fituesit.

Po kështu diferenca ndërmjet procedurave për dhënien me koncesion/PPP, të shpallura fituese me njoftimet e kontratave të nënshkruara është për faktin se negocimi i kontratave kërkon kohë të gjatë në lidhje me përcaktimin e termave koncesionare.

Gjithashtu nga totali i publikimeve rezulton se 3 raste janë procedura të shpallura në 2017, por që janë anuluar po në vitin 2017.

2.6. Statistika në lidhje me procedurat e ankandit publik të zhvilluara gjatë vitit 2017

Gjatë vitit 2017 janë shpallur në Buletinin e Njoftimeve Publike edhe procedura të ankandit publik, procedura këto të cilat zhvillohen vetëm në rrugë shkresore. Konkretisht, rezulton se gjatë vitit 2017 janë publikuar në total **518** Njoftime për shpallje ankandi nga të cilat **225** janë anuluar.



Ndërkohë, sa i takon njoftimeve të fituesve dhe kontratave të nënshkruara të dhënat në lidhje me këto procedura paraqiten si më poshtë:

Tabela 17

Njoftime lidhur me procedurat e ankandeve publike të zhvilluara gjatë vitit 2017		
Procedura të ankandit publik	Numri	Vlera e fituar në lekë
Njoftime Fituesish Ankandi	163	6,352,596,111
Njoftime Kontratash të Nënshkruara Ankandi	47	5,810,544,438

Në analizimin e të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme, duhet mbajtur në konsideratë fakti që në shumë raste ka rezultuar se një subjekt është shpallur fitues në disa lote të procedurave të ankandeve, prandaj edhe numri i kontrave të lidhura është më i vogël se numri i njoftimeve të fituesit.

Të shpërndarë sipas muajve, njoftimet e fituesit dhe njoftimet e kontratave të nënshkruara të procedurave të ankandit, paraqiten si më poshtë:

Tabela 18

Njoftime Fituesish për Ankandet Janar- Dhjetor 2017		
Muaji	Numri i Procedurave	Vlera e fituar (në lekë)
Janar	13	41,858,800
Shkurt	11	51,097,021
Mars	14	11,473,498
Prill	7	7,920,326
Maj	22	284,758,896
Qershor	19	17,464,868
Korrik	16	11,239,181
Gusht	10	45,438,428
Shtator	11	5,771,517,370
Tetor	15	73,169,784
Nentor	14	10,359,912
Dhjetor	11	26,298,027
Totali	163	6,352,596,111



Tabela 19

Njoftime Kontratash të Nënshkruara për Ankandet Janar-Dhjetor 2017		
Muaji	Numri i Kontratave	Vlera e fituar
Janar	6	15,552,220
Shkurt	2	3,086,098
Mars	3	2,210,464
Prill	2	161,280
Maj	2	2,169,060
Qeshor	1	797,640
Korrik	6	5,817,503
Gusht	7	43,348,700
Shtator	3	5,726,114,338
Tetor	7	4,667,520
Nentor	5	5,429,509
Dhjetor	3	1,190,056
Totali	47	5,810,544,438




2.7. Statistika në lidhje me procedurat e krijuara në sistemin elektronik

Numri total i aplikimeve të krijuara nga Njësitë e Prokurimit/Komisionet e Prokurimit me Vlerë të Vogël pranë Autoriteteve Kontraktore për vitin 2017 në Sistemin e Prokurimit Elektronik është 31299. Nga këto:

- 23918 janë aplikime për procedura prokurimi me Vlerë të Vogël nga të cilat 15193 janë të përfunduara me fitues;
- 7380 janë aplikime për Procedura Konsulence, Konkurs Projektimi, Procedura me Negociim me Shpallje Paraprake të Njoftimit, Procedura të Hapura, Kërkesë për Propozim, etj, nga të cilat 4790 janë të përfunduara me fitues.

Në diagramën e mëposhtme tregohet raporti i numrit të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, ndaj procedurave të prokurimit mbi vlerën 800.000 lekë, ku, sikurse dhe nga treguesit e analizuar më sipër, del qartë volumi më i madh që zënë procedurat e prokurimit me vlerë të vogël ndaj procedurave të tjera.

Grafiku 5



Megjithatë, pavarësisht se në raportin në numër dominojnë procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, duhet theksuar se në raportin në vlerë, dukshëm dominojnë procedurat e prokurimit mbi vlerën 800.000, duke qenë se raporti është në të kundërt; **fondi i prokuruar me procedurë prokurimi me vlerë të vogël zë rreth 3 %**, kurse fondi i prokuruar me procedura të tjera zë rreth 97 %.

Grafiku 6





2.8. Statistika në lidhje me autoritetet kontraktore që kanë krijuar procedura në sistemin elektronik

Numri total i autoriteteve kontraktore aktivë që kanë krijuar procedura prokurimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik për vitin 2017 është **1398**, nga të cilët vetëm **549** kanë krijuar procedura prokurimi mbi kufirin e ulët monetar 800.000 lekë.

Gjithashtu, sikundër rezulton nga të dhënat e paraqitura **208 prej këtyre autoriteteve kontraktore kanë krijuar vetëm nga 1 procedurë mbi kufirin e ulët monetar 800.000 lekë.**

Grafiku 7




Tabela dhe Grafiku i mëposhtëm pasqyrojnë numrin e autoriteteve kontraktore që kanë zhvilluar procedura prokurimi mbi 800.000 lekë.

Tabela 20

Numri i Autoriteteve kontraktore	Numri i procedurave
208	1
70	2
40	3
33	4
26	5
16	6
12	7
12	9
9	8



9	15
7	10
7	11
7	12
6	21
5	13
5	14
5	17
5	23
5	26
5	34
4	18
4	20
3	16
3	24
3	27
3	30
3	32
3	36
2	19
2	22
2	25
2	29
2	31
2	44
2	65
1	41
1	43
1	45
1	46
1	49
1	50
1	52
1	53
1	68
1	73
1	74
1	92
1	107
1	120
1	149
1	168
1	204



2.9. Statistika në lidhje me regjistrat e parashikimeve të krijuara në sistemin e Prokurimit elektronik

Si rezultat i përfundimit me sukses të kontratës me objekt *“Ri-inxhinierim dhe shtim i funksionaliteteve/shërbimeve në sistemin e prokurimit elektronik mbështetur nga një teknologji dhe infrastrukturë e re”*, me anë të së cilës është arritur krijimi i Regjistrave të Parashikimeve dhe Realizimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, APP arrin të identifikojë të dhënat për regjistrin e parashikimeve të krijuar nga autoritet kontraktore.

Ky funksionalitet jo vetëm që lehtëson punën dhe shmang burokracitë, por ka futur një koncept të ri në procesin e punës për operatorët ekonomikë. Tashmë operatorët ekonomikë arrijnë që në kohë reale të kenë informacion mbi të gjitha procedurat dhe fondet publike që do të prokurohen gjatë vitit brenda datës 15 janar. Kjo gjë rrit në mënyrë të dukshme transparencën në shpenzimin e fondeve publike.

2.10. Statistika në lidhje me ofertat e krijuara në sistemin elektronik për procedurat e arkivuara

Numri total i ofertave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë në procedurat e shpallura me fitues nga Autoritetet Kontraktore për vitin 2017 në Sistemin e Prokurimit Elektronik është 169364. Nga të cilat:

- 151050 janë oferta të dorëzuara në prokurime Blerje me Vlerë të Vogël;
- 10102 janë oferta të dorëzuara në procedurat e prokurimit Kërkesë për Propozim;
- 7605 janë oferta të dorëzuara në procedurat e prokurimit të Hapura lokale;
- 607 janë oferta të dorëzuara në procedurat e prokurimit Konsulencë, të Hapura ndërkombëtare, etj

Në tabelën e mëposhtme tregohet raporti i numrit të ofertave të dorëzuara në prokurimet me vlerë të vogël, ndaj numrit të ofertave të dorëzuara në procedurat mbi vlerën 800.000 lekë, konkretisht:

Tabela 22

Informacion mbi Ofertat Elektronike per vitin 2017	
	Numri
Numri i Procedurave/ Loteve	7317
Numri total i Ofertave për Procedurat e Prokurimit	10180
Mesatarja e Ofertave për Procedurat e Prokurimit	2.98
Numri i Prokurimeve me Vlerë të Vogël	23918
Numri total i Ofertave për Prokurimet me Vlerë të Vogël	254312
Mesatarja e Ofertave për Prokurimet me Vlerë të Vogël	10.63



Grafiku 9



Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, mesatarja e ofertave në prokurimet me vlerë mbi 800.000 lekë është rreth **3 oferta për procedurë**, kurse në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël kjo mesatare shkon rreth **11 oferta për procedurë**.

Në tabelën e mëposhtme tregohet numri i ofertave të dorëzuara në procedurat e prokurimit nga operatorët ekonomikë sipas llojit të procedurës dhe tipit të kontratës:

Tabela 23

Pjesëmarrja e Operatoreve Ekonomike sipas llojit të procedurës si dhe tipit të kontratës							
Lloji i Procedures	Tipi i Kontrates	Numri procedurave	Numri total i ofertave të dorëzuara		Numri i ofertave të refuzuara	Numri Total i ofertave	Numri mesatar i ofertave
			Numri i ofertave me një Operator Ekonomik	Numri i ofertave të dorëzuara si bashkim Operatorësh Ekonomikë			
Shërbim Konsulencë	Shërbime	137	280	128	186	594	4.34
E hapur mbi kufirin	Shërbime	11	9	7	48	64	5.82
E hapur mbi kufirin	Mallra	17	21	6	17	44	2.59
E hapur mbi kufirin	Punë	1	8	5	3	16	16.00
E hapur	Shërbime	739	827	253	816	1896	2.57
E hapur	Mallra	909	1094	176	1499	2769	3.05
E hapur	Punë	675	896	629	2380	3905	5.79
Kërkesë për Propozim	Shërbime	1211	2707	194	1841	4742	3.92
Kërkesë për Propozim	Mallra	2973	3008	114	2545	5667	1.91
Kërkesë për Propozim	Punë	644	945	346	845	2136	3.32
Totali		7317	9795	1858	10180	21833	2.98
Prokurim me vlerë të vogël	Shërbime	6230	43500	3846	47346	47346	7.60
Prokurim me vlerë të vogël	Mallra	16975	193007	5496	198503	198503	11.69
Prokurim me vlerë të vogël	Punë	713	8194	269	8463	8463	11.87
Totali		23918	244701	9611	254312	254312	10.63

Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, mesatarja më e madhe e ofertave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë është në procedurat e prokurimit "**Kërkesë për Propozim**" dhe "**E hapur**". Kjo për shkak se, këto dy lloj procedurash janë më të përdorurat nga autoritetet kontraktore.



Grafiku 10



Në tabelën e mëposhtme paraqitet mesatarja e dorëzimit të ofertave nga operatorët ekonomikë sipas tipit të kontratës:

Tabela 24

Mesatarja e Ofertave të dorëzuara	Shërbim Konsulence	E hapur mbi kufirin	E hapur	Kërkesë për Propozim
Shërbime	4.34	5.82	2.57	3.92
Mallra	0	2.59	3.05	1.91
Punë	0	16	5.79	3.32

Grafiku 11



Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, mesatarja më e madhe e ofertave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë është në tipet e kontratave **Punë** për procedurën e prokurimit “E hapur” dhe Shërbime për “Kërkesë për Propozim”.

Ndërsa në rastin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, mesatarja më e madhe e ofertave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë është në tipet e kontratave **Mallra** dhe **Punë**.

Tabela 25

Mesatarja e Ofertave të dorëzuara	Mesatarja në Prokurim me Vlerë të Vogël
Shërbime	7.6
Mallra	11.7
Punë	11.87

Grafiku 12





3. INICIATIVAT LEGJISLATIVE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2017

3.1 Ndryshimet legjislative

Sa i takon iniciativave legjislative edhe gjatë këtij viti APP është fokusuar kryesisht në hartimin e projektakteve nënligjore dhe udhëzimeve për unifikimin e praktikave në fushën e prokurimit publik, në dhënien e mendimeve, këshillave apo udhëzimeve në ndihmë të autoriteteve kontraktore, dhënien e mendimeve për projektvendime të ndryshme, si dhe në shqyrtimin e propozimeve për përjashtimin e shoqërive të ndryshme nga e drejta për të marrë pjesë në procedurat e prokurimeve publike, koncensionet/partneritetit publik privat apo procedurat e ankandeve publike.

3.1.1 Ndryshimet në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”

APP ka punuar në drejtim të përgatitjes së projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, i cili u miratua me Ligjin 47/2017.

Qëllimi kryesor i ndryshimit të këtij ligji është riorganizimi i sistemit të ankimimit për prokurimet publike në Republikën e Shqipërisë, duke garantuar pavarësinë e institucioneve përgjegjëse dhe paanshmërinë e tyre në vendimmarrje.

Në vijim të rekomandimeve të dhëna nga Komisioni Evropian në Progres Raportet e vitit 2015 dhe 2016, me qëllim përmirësimin e sistemit të ankimimit për prokurimet publike dhe harmonizimin e legjislacionit shqiptar me acquis-në e BE në këtë fushë, sidomos për sa i përket rritjes së pavarësisë së Komisionit të Prokurimit Publik, u pa e nevojshme që të bëhen ndryshimet në Ligjin për Prokurimin Publik.

Në këtë kontekst, synimi kryesor i ndryshimeve dhe shtesave të paraqitura përmes ligjit 47/2017 është rritja e pavarësisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashikuar përzgjedhjen e anëtarëve të tij nga Kuvendi.

Një nga parashikimet e këtij ligji, i cili ndikon njëkohësisht, në rritjen e pavarësisë së këtij institucioni si edhe në rritjen e përgjegjshmërisë së tij, është edhe fakti se rregullat për organizimin dhe funksionimin e tij tashmë do të miratohen nga vetë KPP.

Në ndryshimet e tjera të miratuara me këtë ligj janë edhe sanksionimi i parimeve mbi bazën e të cilave, KPP do të mbështetet për marrjen e vendimeve të saj siç janë; (i) paanshmëria në shqyrtimin e ankesave, (ii) qëndrueshmëria në vendimmarrje, (iii) ligjshmëria, (iv) shpejtësia dhe efica, (v) akses, (vi) karakteri publik si edhe parimi i kontradiktoritetit.

Këto parime, do të jenë mjaft të rëndësishme sidomos në drejtim të unifikimit të vendimeve që KPP duhet të bëjë në shqyrtimin e ankesave për të njëjtën çështje.

3.1.2 Ndryshime në Rregullat e Prokurimit Publik

a) Gjatë tremujorit të fundit të këtij viti është punuar në drejtim të përmirësimit të rregullave të prokurimit publik.



Domosdoshmëria për rishikimin e kuadrit legjislativ për prokurimin publik dhe më konkretisht, të rregullave për prokurimin publik erdhi si rezultat i problematikave të ndryshme të hasura në praktikë gjatë procesit të prokurimit, të cilat janë përcjellë në APP nga autoritetet kontraktore, apo rekomandime të ndryshme të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, kërkesave të paraqitura për ndryshime nga institucione të ndryshme, sipas fushave respektive të kompetencës si dhe çështjeve të paraqitura në APP nga operatorë të ndryshëm ekonomikë, apo shoqata që përfaqësojnë interesat e tyre.

Ndryshimet u miratuan me VKM nr. 797, datë 29.12.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar”, të cilat kanë hyrë në fuqi në datë 4 janar 2018, me botimin e tyre në Fletoren Zyrtare.

Risite që solli ky vendim qëndrojnë jo vetëm në rikonceptimin e mënyrës së organizimit të procesit të prokurimit, por edhe të rritjes së përgjegjësisë së autoriteteve kontraktore duke filluar nga mirëplanifikimi i fondeve publike që do të prokurojnë deri në monitorimin e zbatimit të kontratës.

b) Përveç ndryshimeve të sipërcituara në rregullat e prokurimit publik, paralelisht është punuar edhe me rishikimin e VKM nr.918, datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”.

Me qëllim rritjen e transparencës, APP ka punuar për përshtatjen e funksionaliteteve të sistemit të prokurimit elektronik, për zhvillimin e procedurës së prokurimit “negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik.

Me miratimin dhe hyrjen në fuqi të VKM nr. 796, datë 29.12.2017 “Për një ndryshim në VKM nr. 918, datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”, u sanksionua detyrimi i zhvillimit të procedurës së prokurimit “negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik.

3.1.3 Udhëzime, Rekomandime dhe Njoftime të APP

Gjatë vitit 2017, për t’u ardhur në ndihmë autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë, është punuar në drejtim të hartimit të rekomandimeve apo të ndryshimeve në Udhëzimet e APP, të cilat erdhën, edhe si rezultat i përmirësimit të sistemit të prokurimit elektronik nëpërmjet shtimit të disa funksionaliteteve të tij.

Gjatë këtij viti APP ka hartuar 9 (nëntë) Udhëzime, 3 (tre) Rekomandime si dhe 5 (pesë) Njoftime.

Më konkretisht:

3.1.3.1. Udhëzimet

Në kuadër të ndryshimeve dhe përmirësimeve të funksionaliteteve/shërbimeve në sistemin e prokurimit elektronik, APP ka hartuar dhe publikuar Udhëzimet e përkatëse.

Këto udhëzime adaptojnë të reja që solli përmirësimi i funksionaliteteve të sistemit jo vetëm në drejtim të krijimit të procedurave në sistemin e prokurimit elektronik, por edhe të shqyrtimit dhe vlerësimit të tyre.

Po kështu, është punuar në drejtim të standartizimit të procesit të anulimit të procedurës së prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik.



- 1) Udhëzimi Nr. 01, datë 14.04.2017 “Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël në SPE”.
- 2) Udhëzimi i APP Nr. 02 datë 24.4.2017 që ndryshon Udhëzimi Nr. 03, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”, të ndryshuar.
- 3) Udhëzimi Nr. 3, datë 09.05.2017 “Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronik”.
- 4) Udhëzimi nr. 4, datë 09.05.2017 “Për veprimet e njësisë së prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik”.
- 5) Udhëzimi Nr. 05, datë 05.07.2017 “Për veprimet e Administratorit të Sistemit të Autoritetit Kontraktor në Sistemin e Prokurimit Elektronik”;
- 6) Udhëzimi Nr. 06 datë 13.09.2007 “Për disa shtesa dhe një ndryshim në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.04.2017 “Për zhvillimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël në Sistemin e Prokurimit Elektronik”;
- 7) Udhëzimi Nr. 07, datë 13.09.2017 “Për një ndryshim në Udhëzimin Nr. 3, datë 09.05.2017 “Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në Sistemin e Prokurimit Elektronik”;
- 8) Udhëzimi Nr. 08, datë 13.09.2017 “Për disa shtesa në Udhëzimin Nr. 4, datë 09.05.2017 “Për veprimet e Njësisë së Prokurimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik”;
- 9) Udhëzimi Nr. 09, datë 18.09.2017 “Për një ndryshim në Udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.3, datë 27.01.2015 “Për procedurën procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”, të ndryshuar”;
- 10) Udhëzimi Nr. 10, datë 01.11.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr.6 datë 27.01.2015 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër”.

Megjithëse, parashikimet mbi përdorimin e marrëveshjes kuadër janë adoptuar prej kohësh në legjislacionin e prokurimit publik, nga praktika e deritanishme ka rezultuar se, vetëm një numër i vogël autoritetesh kontraktore ka aplikuar përdorimin e këtij instrumenti, për të lidhur kontrata publike.

Nga ana tjetër, duke iu referuar praktikës së deritanishme, përdorimi i marrëveshjes kuadër është i përqendruar kryesisht në prokurimin e biletave të transportit ndërkombëtar ajror.

Duke qenë se, janë vërejtur zvarritje të procedurave të prokurimit nga autoritetet kontraktore për shkaqe nga më të ndryshme, të cilat kanë çuar në një rritje të numrit të përdorimit të procedurave të prokurimit me “negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, në rolin e rregullatorit të sistemit të prokurimit publik, APP ka punuar në drejtim të nxitjes së autoriteteve kontraktore që të përdorin gjërësisht marrëveshjen kuadër, si një nga instrumentet kryesore që mund të ndikojë në parandalimin e efekteve të sipërpërmendura, të cilat kanë kosto financiare në buxhet.

Për këtë qëllim, APP ka rishikuar Udhëzimin për marrëveshjen kuadër për të mundësuar, prokurimin me anë të saj të mallrave dhe shërbimeve me natyrë të përsëritur dhe me përdorim të zakonshëm.



3.1.3.2 Rekomandimet

1. Rekomandimi i përbashkët me Komisionin e Prokurimit Publik datë 06.02.2017 “Mbi mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit për shërbimin privat të ruajtjes fizike”.

APP ka bashkëpunuar me Komisionin e Prokurimit Publik në drejtim të rishikimit të rekomandimit të përbashkët të datës 01.04.2015, me objekt “Mbi mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit për shërbimin privat të ruajtjes fizike” me qëllim shmangien e problematikave gjatë zhvillimit të këtyre lloj procedurave duke orientuar autoritetet kontraktore në hartimin e kriterëve për kualifikim dhe operatorët ekonomikë për përgatitjen e ofertës.

Ky rekomandim është rishikuar dhe përmirësuar më tej me anë të rekomandimit të përbashkët Nr. 15166 Prot., dhe Nr. 1858 Prot., APP dhe KPP datë 20.12.2017.

2. Gjatë procesit të verifikimit të zbatimit të ligjshmërisë së procedurave të prokurimit nga APP në ushtrim të funksioneve të saj, sipas parashikimeve të nenit 13/2/g të LPP, të cilat kanë si objekt shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim, si dhe duke u nisur nga ankesa të shumta që operatorët ekonomikë kanë paraqitur për këto procedura prokurimi, APP ka vërejtuar parregullsi në hartimin e fondit limit dhe përgatitjen e ofertave nga operatorët ekonomikë.

Kështu, me qëllim që t’i vijë në ndihmë autoriteteve kontraktore në përlogaritjen e fondit limit, por edhe operatorëve ekonomikë në përgatitjen e ofertave të tyre, APP ka hartuar një material orientues i cili është publikuar në faqen zyrtare.

3.1.3.3 Njoftimet

1. Njoftimi Nr. 9853 Prot., datë 06.07.2017 publikuar në faqen zyrtare të APP.

Gjatë këtij viti është miratuar dhe ka hyrë në fuqi edhe Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.482, datë 05.07.2017 “Për pezullimin e përkohshëm të procedurave të prokurimit për vitin 2017”.

Në zbatim të vendimit të sipërcituar, APP ka hartuar një njoftim për të gjitha autoritetet kontraktore, duke i njoftuar këta të fundit që të marrin të gjitha masat paraprake për mos nisjen e procedurave të reja të prokurimit, si dhe për pezullimin e përkohshëm të të gjitha procedurave të prokurimit të filluara.

Ndërkohë, me shfuqizimin e vendimit të sipërcituar (Vendimi 580/2017), APP ka vijuar me njoftimin për autoritetet kontraktore duke i këshilluar këto të fundit që të marrin masat për nisjen e procedurave të prokurimit si dhe për vazhdimin e atyre të cilat kanë qenë të pezulluara.

Gjithashtu, autoritetet janë orientuar edhe mbi veprimet përkatëse që duhet të kryejnë në Sistemin e Prokurimit Elektronik sa i takon heqjes së procedurave të prokurimit nga faza e pezullimit.

2. Në kuadër të procesit të ristrukturimit të institucioneve të Administratës Publike, APP ka publikuar një Njoftim, drejtuar njësive të qeverisjes qendrore dhe institucioneve në varësi të tyre, të cilat janë bashkuar apo shkrirë, mbi veprimet që duhet të kryejnë në Sistemin e Prokurimit Elektronik, duke qenë se kanë luajtur rolin e autoritetit kontraktor, në kuptim të ligjit nr. 9643/2016 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.



3. Pavarësisht materialit orientues të publikuar nga APP mbi përlogaritjen e fondit limit, por edhe të përgatitjes së ofertave në procedurat e prokurimit që kanë si objekt shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim, kanë vijuar ankesat nga operatorët ekonomikë, sa i takon mosrespektimit të tarifave të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” nga autoritetet kontraktore.

Për këtë qëllim, APP ka publikuar Njoftimin me objekt “Tërheqje Vëmendje” drejtuar autoriteteve kontraktore, duke i vënë në dijeni për respektimin e rekomandimit mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e sipërcituar.

4. Njoftimi Nr. 14307 Prot., datë 23.11.2017 “Mbi barazvlefshmërinë e dokumenteve administrative elektronike me dokumentet zyrtare”.

Ky njoftim është hartuar duke marrë shkas nga VKM Nr. 495, datë 13.09.2017 “Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike”, më konkretisht të parashikimeve të nenit 5 të Kreut II të saj, ku shprehimisht citohet se të gjitha dokumentet administrative elektronike që përfitohen nga transmetimi elektronik i të dhënave, me vulë elektronike, kanë të njëjtën vlerë ligjore dhe fuqi provuese si çdo dokument tjetër zyrtar.

Me qëllim lehtësimin e procedurave konkurruese për operatorët ekonomikë, si dhe eliminimin e kostove administrative, APP ka njoftuar autoritetet kontraktore që dokumentet administrative elektronike që lëshohen nga portali unik qeveritar e-albania, apo nga portale të pavarura, duhet të konsiderohen si të barazvlefshme me çdo dokument tjetër zyrtar.

Nisur nga fakti se, një pjesë e mirë e dokumenteve administrative elektronike që lëshohen nga këto portale, përdoren nga operatorët ekonomikë si pjesë e ofertës së tyre edhe në procedurat e prokurimit publik, atëherë APP udhëzon autoritetet kontraktore që të mbajnë në konsideratë parashikimet e VKM Nr. 495, datë 13.09.2017 “Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike”, gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave.

- 5) Njoftimi Nr. 15166 Prot., datë 20.12.2017.

Nëpërmjet këtij njoftimi, APP ka nxitur autoritetet kontraktore që të përdorin Marrëveshjen Kuadër për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, duke qenë një shërbim i përsëritur dhe i vazhdueshëm.

Për këtë qëllim, autoritetet kontraktore janë orientuar që të marrin të gjitha masat për shpalljen e menjëhershme të procedurave të prokurimit me Marrëveshje Kuadër, duke patur në konsideratë edhe parashikimet e këtij Rekomandimi, me qëllim mbulimin e nevojave me këtë shërbim duke shmangur përdorimin e procedurës së prokurimit “negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”.

- Për t’i ardhur në ndihmë autoriteteve kontraktore së bashku me Rekomandimin e përbashkët mbi shërbimin e rojeve si dhe Njoftimin përkatës është publikuar edhe dhe një set model i Dokumentave Standarde për Shërbime, ku si referencë është marrë procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim”.
- Me qëllim nxitjen e autoriteteve kontraktore që të përdorin marrëveshjen kuadër, Agjencia e Prokurimit Publik, ka zhvilluar takime edhe me përfaqësues të autoriteteve kontraktore, ku fillimisht me përfaqësues të pushtetit ekzekutiv, për të vazhduar më pas me pushtetin vendor dhe institucionet e tjera të pavaruara, duke i parashtruar atyre problematikat e hasura në sistemin e prokurimit publik, sidomos sa i takon rritjes së numrit të përdorimit të procedurës së prokurimit “negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”.



Në këtë kuptim, është punuar shumë në drejtim të ndërgjegjësimit të autoriteteve kontraktore sa i takon përdorimit të kësaj lloj procedure prokurimi, duke i propozuar zhvillimin e procedurave të prokurimit nëpërmjet “Marrëveshje Kuadër”, për të mbuluar nevojat për mallrat dhe shërbime të vazhdueshme.

Jo vetëm në takimet e zhvilluara me autoritetet kontraktore, por edhe në këshillat dhe sugjerimet e dhëna nga APP, në ushtrim të kompetencave të saj sipas parashikimeve të nenit 13/2/d të LPP, të gjithë autoritetet kontraktore janë udhëzuar të marrin masat e nevojshme për fillimin menjëherë të procedurave të prokurimit nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër, për të gjitha kategoritë e mallrave dhe shërbime të zakonshme me natyrë të përsëritur me qëllim që, këto objekte prokurimi të jenë siguruar në fillim të vitit kalendarik, për të bërë të mundur ecurinë normale të veprimtarisë së tyre.

Përdorimi i marrëveshjes kuadër është mënyra e duhur që autoritetet kontraktore të kenë nevojat e tyre të plotësuara në fillim të vitit, duke çuar në shmangien e përdorimit të procedurës së prokurimit “negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, si një procedurë jo konkurruese dhe jo transparente.

- Gjatë tremujorit të fundit të vitit 2017, ashtu edhe siç u theksua edhe më sipër është ndërmarrë nga APP fushata për ndërgjegjësimin e autoriteteve kontraktore mbi kufizimin e përdorimit të procedurës së prokurimit “negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” dhe përdorimin e saj vetëm në situatat e parashikuara nga ligji. Ajo që vlen të theksohet është edhe nxitja e Organit Qendror Blerës për të zhvilluar procedurat e prokurimit të përqendruara nëpërmjet marrëveshjes kuadër.

Për këtë qëllim, APP i është drejtuar me shkresë të veçantë Organit Qendror Blerës, duke i theksuar rëndësinë dhe rolin që ka ky organ në procesin e prokurimit sa i takon nisjes në mënyrë të menjëhershme të procedurave me qëllim shmangien e përdorimit të procedurave të prokurimit “negociim pa shpallje paraprake” nga autoritetet kontraktore, të cilat detyrohen të plotësojnë nevojat e tyre deri të në finalizimin e procedurave të përqendruara nga ky Organ.

3.1.4. Ndryshime në dokumentat standarde të tenderit

Në mbështetje të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 13 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, APP me Vendimin Nr.1 datë 03.05.2017 ka rishikuar setin e Dokumentave Standarde të Tenderit për Procedurën e Prokurimit “Negociim me Shpallje Paraprake të Njoftimit të Kontratës”, për kontratat e furnizimit të mallrave, shërbimeve dhe punëve publike.

Në këtë set dokumentash janë rishikuar Shtojca “Formulari i Publikimit të Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar », si dhe Shtojca « Formulari i Publikimit të Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar » e cila publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Rishikimi i këtyre dy shtojcave ka patur si qëllim që të pasqyrojë, në rastin e përdorimit të procedurës së prokurimit « negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës », përveç marrjes së informacionit në rastin e shtesave të kontratave, edhe rastet e tjera ligjore kur kjo procedurë prokurimi do të përdoret.

Marrja e këtij informacioni do të përmirësojë ndjeshëm punën statistikore në drejtim të mbledhjes së të dhënave, mbi rastet kur përdoret më shpesh kjo lloj procedure prokurimi.



4. TREGUES TË VEPRIMTARISË KËSHILLUESE DHE PËRFAQËSUESE TË APP GJATË VITIT 2017

4.1. Praktikët e shqyrtuara për dhënie mendimesh, këshilla apo udhëzimesh gjatë këtij viti

Në zbatim të detyrave që i ngarkojnë legjislacioni në fushën e prokurimit publik, koncesioneve/ppp dhe ankandit publik, APP ka shqyrtuar një numër të konsiderueshëm praktikash, të cilat kanë pasur të bëjnë me dhënien e mendimeve, këshillave apo udhëzimeve në ndihmë të autoriteteve kontraktore, dhënien e mendimeve për projektvendime të ndryshme, udhëzime për unifikimin e praktikave, shqyrtimin e propozimeve të autoriteteve kontraktore apo edhe të operatorëve ekonomike për përjashtimin e subjekteve të ndryshme nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit dhe koncesioneve/ppp.

Konkretisht, numri total i praktikave të paraqitura në këtë sektor për mendim, sqarim apo informacione nga institucione të ndryshme, për çështje që lidhen me procesin e prokurimit publik, koncesioneve/PPP-ve, dhe ankandeve publike gjatë vitit 2017 është **405**.

Në formë tabelore këto të dhëna janë si më poshtë:

Praktikat e shqyrtuara nga APP gjatë vitit 2017 sipas llojit të kërkesës	
Lloji i Kërkesës	Numri
Kërkesa për dhënie mendimi/sqarimi	225
Kërkesa për dhënie mendimi mbi projevendimet/projektligjet e paraqitura	7
Verifikime të kërkuara nga DSIK pranë Kryeministrit	12
Vërtime të lëshuara për operatorët ekonomikë që nuk janë në proces përjashtimi	37
Kërkesa të paraqitura nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor/inst të ndryshme	27
Ankesa nga operatorë ekonomikë	27
Verifikime të kërkuara nga IDKPKI	70
Totali	405

Përveç komunikimeve shkresore, Sektori Juridik është i angazhuar edhe në trajtimin e kërkesave që i përcillen nëpërmjet adresës elektronike të APP, të shpallur në faqen e internetit.

Në këtë drejtim ka patur një angazhim maksimal në trajtimin e kërkesave për mendim apo dhënie këshille, dërguar jo vetëm nga autoritetet kontraktore por edhe nga operatorët ekonomikë.



Duke ju referuar numrit të emailleve të trajtuara gjatë këtij viti kalendarik rezultojnë se janë trajtuar **rreth 200 të tilla** me problematikat nga më të ndryshmet, duke filluar nga kërkesat e shumta që ka patur për dhënie interpretimi mbi fushën e zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 482, datë 05.07.2017 “Për pezullimin e përkohshëm të procedurave të prokurimit për vitin 2017”, apo në lidhje me përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit, përcaktimit të zërave të preventivit të shpenzimeve për një roje, etj.,

Ndërsa, kërkesat e operatorëve ekonomikë janë drejtuar më së shumti duke kërkuar informacion për procedurat që duhet të ndjekin për të bërë një ankimim, nëse dokumentacioni që dorëzon operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës, duhet të jetë original apo dhe kopje e noterizuar, ankesa sa i takon zhvillimit të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim, etj.

4.2. Shqyrtimi i propozimeve për përjashtimin e operatorëve ekonomikë

Një kompetencë tjetër ligjore e APP, që është ushtruar nëpërmjet këtij sektori gjatë vitit 2017, ka qenë dhe marrja në shqyrtim e propozimeve të autoriteteve kontraktore, operatorëve ekonomikë, të Komisionit të Prokurimit Publik apo organe të tjera audituese në ushtrim të funksioneve të tyre, të cilët kanë kërkuar përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga e drejta për të ofertuar në procedura prokurimi publik, koncensionit/partneriteti publik privat apo procedura ankandi publik, për një periudhë të caktuar kohore.

Ashtu siç theksuam edhe më lart, kjo kompetencë ligjore nuk ushtrohet kryesisht nga APP por vetëm në bazë të reklamimeve që bëhen nga palët e treta të cituara më lart. Në këtë kuptim, kërkesat e paraqitura gjatë këtij viti kalendarik ashtu siç do e analizojmë edhe më poshtë në një pjesë të mirë të tyre kanë qenë të paplota, në kuptim të argumentave ligjore që kërkon neni 13/3 i LPP për përjashtimin e një operatori ekonomik nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, koncensionit/partneritetit publik privat apo ankandeve publike.

Konkretisht gjatë vitit 2017 janë marrë në shqyrtim **58 propozime për përjashtimin e operatorëve ekonomikë**, nga të cilat ka filluar procedimi administrativ për përjashtimin nga procedurat e prokurimit për **30** operatorë ekonomikë.

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, është **marrë vendimi për përjashtimin** nga e drejta për të marrë pjesë në prokurime, për **13 (trembëdhjetë)** operatorë ekonomikë dhe, nga e drejta për të marrë pjesë në koncensione/partneritet publik privat **për 1 (një)** operator ekonomikë. Nga këta:

- **6 (gjashtë)** Operatorë Ekonomikë janë përjashtuar për shkak të keqinformimit, nëpërmjet paraqitjes në tender të dokumentave, që përmbajnë të dhëna të rreme, sipas përcaktimeve të nenit 13/3/a të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- **1 (një)** Operator Ekonomik është përjashtuar nga pjesëmarrja në koncensione/partneritet publik privat për shkak të keqinformimit, nëpërmjet paraqitjes në koncension të dokumentave, që përmbajnë të dhëna të rreme, sipas përcaktimeve të nenit 13/3/a të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- **7 (shtatë)** Operatorë Ekonomikë janë përjashtuar për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas përcaktimeve të nenit 13/3/ç të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.



Në përfundim të procedimit administrativ të nisur nga APP, është **marrë vendim për mos përjashtimin** nga prokurimet publike për:

8 (tetë) Operatorë Ekonomikë, pasi në bazë të dokumentacionit të administruar nuk është provuar se, këta operatorë ekonomikë kanë qenë në kushtet e parashikuara në nenin 13/3 të LPP për përjashtimin e tyre nga pjesëmarrja në prokurimet publike .

- Gjatë procedimit administrativ të nisur për përjashtimin e operatorëve ekonomikë për mospërbushje të detyrimeve kontraktuale është konstatuar se, zgjidhja e çështjes së paraqitur për përjashtim ka qenë në kompetencë të Gjykatës, pasi mospërbushja e detyrimit kontraktual të pretenduar ka qenë objekt i kërkesë padisë së ngritur pranë kësaj Gjykate apo ka patur edhe raste kur në mbështetje të Kodit të Procedurave Administrative vetë APP ka vendosur pezullimin e procedimit të nisur. Në këto kushte:

Për 6 (gjashtë) operatorë ekonomikë, nga APP është marrë **vendim për pezullimin** e procedimit administrativ, deri sa gjykata të shprehej me vendim përfundimtar për këto çështje, apo të përfundonte procesi i monitorimit i nisur prej saj.

Procedimi administrativ i nisur nga APP është ende në proces për 6 (gjashtë) operatorë ekonomikë.

- **Për 2 (dy)** operatorë ekonomikë është në proces shqyrtimi i kundërshtimeve të paraqitura në kuadër të procedimit administrativ të nisur për këto operatorë.

Ndërsa, **për 28 (njëzet e tetë)** operatorë ekonomikë, APP nuk ka nisur procedimin administrativ pasi kërkesa e paraqitur nga propozuesit është konsideruar me dokumentacion të pamjaftueshëm dhe e paargumentuar për të filluar procedimin administrativ, apo në disa raste ju është kërkuar edhe plotësim i dokumentacionit, sipas kushteve të nenit 13/3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Kërkesat për përjashtim të shqyrtuara nga APP gjatë vitit 2017 sipas llojit të vendimit	
Vendimi	Numri
Vendime përjashtimi	14
Vendime mos përjashtimi	8
Procedime administrative të pezulluara	6
Procedime administrative në proces	2
Kërkesa të paplota	28
Totali	58



4.3 PËRFAQËSIMI NË PROCESET GJYQËSORE

Gjatë vitit 2017, APP është përfaqësuar në proceset gjyqësore si palë e paditur kryesisht nga zyrtarët e autoriteteve kontraktore të dënuar me gjobë në përfundim të procesit të monitorimit të ushtruar nga APP apo nga shqyrtimi i raporteve audituese.

Gjithsej në vitin 2017, nga APP janë ndjekur 136 çështje gjyqësore, nga të cilat 88 çështje në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, 28 çështje të përfunduara nga Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë dhe 19 çështje në Gjykatën e Lartë.

Çështjet Gjyqësore të ndjekura nga APP sipas shkallës së gjykimit	
Shkalla e Gjykimit	Numri
Gjykata Administrative e shkallës së parë	89
Gjykata Administrative e Apelit	28
Gjykata e Lartë	19
Totali	136

Çështjet Gjyqësore të ndjekura nga APP sipas në shkallë të parë sipas llojit të kërkesë padisë	
Lloji i padisë	Numri
Kundër vendimeve të APP për përjashtimin e operatorëve ekonomikë	5
Kundër vendimeve të APP për dënimin me gjobë	82
Çështje gjyqësore me objekt Marrëdhëniet e punës	2
Totali	89

Në **5 (pesë) çështjet** gjyqësore kundër vendimeve të APP për përjashtimin e operatorëve ekonomikë në **4** (katër) prej tyre është vendosur rrëzimi i kërkesë padisë dhe në **1** (një) çështje është pranuar kërkesë padia.



Çështjet Gjyqësore kundër vendimit të dënimit me gjobë sipas vendimit të Gjykatës	
Vendimi i Gjykatës	Numri
Rrëzuar kërkesë padia	35
Pranuar kërkesë padia	20
Mospranim Kërkesë padisë	1
Pranim pjesërisht i kërkesë padisë	4
Pushimi i Çështjes	1
Në proces	23
Totali	84


Nga 84 çështjet gjyqësore kundër vendimeve të APP për dënime me gjobë, në përfundim të procesit të monitorimit apo të shqyrtimit të raporteve të auditimit, si dhe ndërprerjes së marrëdhënieve të punës 61 çështje kanë përfunduar në shkallë të parë, dhe konkretisht Gjykata ka vendosur:

në 20 çështje pranimin e kërkesë padisë;


- në 35 çështje rrëzimin e kërkesë padisë;
- në 1 çështje mospranimin e kërkesë padisë;
- në 4 çështje është vendosur pranim pjesërisht i kërkesë padisë
- në 1 çështje është vendosur pushimi i gjykimit.

Ndërkohë që 23 çështje janë në proces gjykimi.

Ashtu siç do e shikojmë edhe nëpërmjet grafikut të mëposhtëm rreth 42% të çështjeve gjyqësore kanë përfunduar me rrëzimin e kërkesë padisë, ç'ka do të thotë që vendimi i marrë nga APP është gjykuar i drejtë dhe i bazuar në ligj. Në 24 % të rasteve është vendosur për pranimin e kërkesë padisë dhe, ndërkohë mbeten në proces 27 % të çështjeve, të cilat nuk janë mbyllur ende këtë vit.



Nga 61 vendimet gjyqësore për çështjet e përfunduara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, 58 vendime të dhëna nga kjo gjykatë kanë qenë të formës së prere.



Nga grafika e mësipërme rezulton se 95% e vendimeve të dhëna nga Gjykata Administrative e Shkallës së parë kanë qenë të formës së prerë, kjo për shkak të masës së gjobës së vendosur nga APP, e cila nuk tejkalon 20 fishin e pagës minimale në shkallë vendi.

Ndërkohë, **3 vendime gjyqësore** janë apeluar në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë, nga të cilat:

- 2 vendime janë apeluar nga APP dhe
- 1 vendime është apeluar nga pala tjetër ndërgjyqëse.

Vendime gjyqësore të apeluara sipas palës apeluese	
Palë apeluese	Numri
Apeluar nga APP	2
Apeluar nga pala tjetër ndërgjyqëse	1
Totali	3



Çështjet e apeluara në Gjykatën Administrative të Apelit, janë ende në proces.

- Në gjykatën Administrative të Apelit gjatë këtij viti kanë përfunduar **28 çështje**, nga të cilat **18 (tetëmbëdhjetë)** kanë qenë të formës prerë, dhe për **10 (dhjetë)** prej tyre është ushtruar rekurs pranë Gjykatës së Lartë.

Nga 28 çështje të përfundurara, 27 prej tyre kanë qenë ankimim ndaj vendimeve të dhëna nga APP për dënime me gjobë, në përfundim të procesit të monitorimit apo të shqyrtimit të raporteve të auditimit dhe vetëm 1 (një) ankim ndaj vendimit të dhënë nga APP mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

Nga 28 çështje gjyqësore, të përfunduara me vendim të kësaj Gjykata ka rezultuar se:

- Për 6 çështje gjyqësore, është vendosur prishja e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe dërgimi i çështjes për rigjykim në atë gjykatë me tjetër trup gjykues.
 - Për 8 çështje gjyqësore është vendosur lënia në fuqi e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për rrëzimin e kërkesë padisë.
 - Për 10 çështje gjyqësore është vendosur lënia në fuqi e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për pranimin e kërkesë padisë.
 - Për 1 çështje gjyqësore është vendosur pushimi i gjykimit.
 - Për 2 çështje gjyqësore është mospranimi i ankimit.
- Përveç çështjeve gjyqësore pranë gjykatave administrative, sikurse analizuar më sipër, APP është palë në **19 çështje** në Gjykatën e Lartë, të cilat janë ende në proces.
 - Në rastin e fletëthirrjeve për t'u paraqitur si palë ndërgjyqëse në Gjykatat Administrative në Rrethe, APP iu është drejtuar këtyre të fundit me kërkesë për shpalljen e moskompetencës, sipas ligjit 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

Konkretisht, kanë ardhur fletëthirrje për 11 çështje gjyqësore nëpër rrethe, të cilave i është dërguar kërkesa për shpalljen e moskompetencës tokësore dhe dërgimin e çështjeve për gjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Në 4 raste këto gjykata kanë pranuar kërkesën e APP për shpalljen e moskompetencës tokësore, dhe në 1 rast gjykatat e rretheve kanë refuzuar kërkesën e APP për shpalljen e moskompetencës dhe kanë vazhduar me gjykimin e saj. Për 6 çështje, nuk është marrë njoftim mbi pranimin ose jo të kërkesës së dërguar për shpalljen e moskompetencës.

Çështje gjyqësore në rrethe sipas vendimit të marrë	
Vendimi	Numri
Pranim kërkesë për shpallje moskompetence	4
Refuzim kërkesë për shpallje moskompetence	1
Në proces	6
Totali	11



5. TREGUES TË VEPRIMTARISË SË MONITORIMIT TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT

Në vijim janë të paraqitura rezultatet në kuadër të Monitorimit të procedurave të prokurimit gjatë vitit 2017, vendimet e marra, problematikat e konstatuara gjatë procesit të monitorimit dhe shqyrtimit të raporteve të organeve audituese, iniciativat e nevojshme për shmangien e tyre në të ardhmen.

5.1. Verifikimi i zbatimit të ligjshmërisë

Verifikimi i zbatimit të ligjshmërisë në procedurat e prokurimit të zhvilluara nga autoritete të ndryshme kontraktore, pas fazës së nënshkrimit të kontratës, është një proces i vazhdueshëm i veprimtarisë së APP.

Nëpërmjet këtij procesi synohet në ndërgjegjësimin e autoriteteve kontraktore për zbatimin me rigorozitet të legjislacionit të prokurimit publik, në procedurat e prokurimit që zhvillohen prej tyre.

Në rolin e saj, si rregullator i sistemit të prokurimit publik në vend, APP fokuson procesin hetimor në evidentimin e problematikave, që lidhen me respektimin e kërkesave ligjore, si vijon:

- *përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (në rastet kur procedura e prokurimit përdoret në rrethana të caktuara siç është procedura “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”), plotësimin e kushteve ligjore dhe administrimin nga AK, të dokumentacionit të nevojshëm për këtë qëllim;*
- *mënyrën e përlogaritjes së fondit limit, argumentimin përkatës, si dhe administrimin nga AK, të dokumentacionit të nevojshëm për këtë qëllim;*
- *hartimin e specifikimeve teknike, argumentimin përkatës, si dhe administrimin nga AK, të dokumentacionit të nevojshëm për këtë qëllim;*
- *hartimin e kriterëve të pranimit, argumentimin përkatës, si dhe administrimin nga AK, të dokumentacionit të nevojshëm për këtë qëllim;*
- *shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, sipas kriterëve të përcaktuara në dokumentat e tenderit, trajtimin e barabartë të ofertuesve në procedurë;*
- *trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë, sipas afateve kohore në dispozicion të operatorëve ekonomikë;*
- *veprimet e tjera proceduriale, që ndiqen nga autoriteti kontraktor gjatë procesit të prokurimit.*

Sa i takon procedurës së prokurimit “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, synimi i monitorimit të vazhdueshëm të saj, ka qenë identifikimi i shkaqeve që çojnë një autoritet kontraktor në përdorimin e kësaj lloji procedure, kontrolli i përmbushjes dhe zbatueshmërisë së kushteve të parashikuara nga legjislacioni i prokurimit publik për këtë rast, parandalimin e përzgjedhjes së pajustificuar të kësaj lloji procedure në të ardhmen, me qëllim minimizimin e rateve të përdorimit të saj në të ardhmen.



Gjithashtu, në fokusin e monitorimit kanë qenë edhe procedura normale prokurimi, për të cilat lind nevoja e verifikimit të zbatimit të ligjshmërisë, bazuar në vlerën e lartë të fondit limit, vlerën e ulët të kursyer, dhe faktit që zhvillohen nga autoritete kontraktore, të cilat nuk kanë qenë subjekt monitorimi për një periudhë kohe nga APP.

Nëpërmjet procesit të monitorimit, APP nuk ka për qëllim vetëm evidentimin e parregullsive dhe problematikave, penalizimin e personave përgjegjës, të cilët rezultojnë të kenë kryer veprime në kundërshtim me dispozitat ligjore të prokurimit, por edhe dhënien e rekomandimeve përkatëse për shmangien e këtyre veprimeve, në të ardhmen.

Po kështu, analizimi i konkluzioneve të arritura në përfundim të hetimeve administrative, mund të shërbejë si bazë për nxjerrjen e rekomandimeve përgjithësuese, të cilat i shërbejnë të gjithë autoriteteve kontraktore, dhe si bazë për përmirësime të mundshme në legjislacionin e prokurimit publik.

Gjatë vitit 2017, në monitorimin e procedurave të prokurimit, APP ka proceduar si vijon:

- Hetimi administrativ është iniciuar Kryesisht, duke hartuar dhe zbatuar një Plan Monitorimi, ku janë përfshirë procedura prokurimi të zhvilluara nga autoritete të ndryshme kontraktore apo duke verifikuar raste të evidentuara nga publikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik apo Buletini i Njoftimeve Publike;
- Në fillim të këtij viti, u finalizua hetimi administrativ për 13 procedura prokurimi, të zhvilluara nga 11 Autoritete Kontraktore, të cilat kanë qenë të përfshira në planin e monitorimit paraardhës.
- Në Planin e Monitorimit, të hartuar dhe zbatuar në katërmujorin e dytë të këtij viti, kanë qenë subjekt monitorimi 15 Autoritete Kontraktore dhe një total prej 16 procedurash prokurimi.

Në përzgjedhjen e procedurave të prokurimit, të përfshira në këtë plan, APP u bazua në informacionin/të dhënat statistikore, të përpunuara nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Buletini i Njoftimeve Publike.

Duke marrë për bazë fondin limit dhe natyrën e objektit të prokurimit, u përzgjedhën si objekt monitorimi, 10 procedura prokurimi me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe 6 procedura të hapura prokurimi.

- Përveç procedurave të përfshira në këtë plan, APP ka zhvilluar hetim administrativ edhe për 7 procedura prokurimi, të zhvilluara nga 4 Autoritete Kontraktore, duke marrë shkas nga vonesat e këtyre autoriteteve, në dërgimin e njoftimeve përkatëse, për publikim.
- Verifikimi i drejtpërdrejtë i rasteve të reklamuar nga operatorët ekonomikë ose të përcjella për kompetencë në APP nga institucione të tjera, si: Kontrolli i Lartë i Shtetit, Komisioni i Prokurimit Publik apo organe të tjera audituese.

Gjatë vitit 2017, në APP (në adresën elektronike dhe në rrugë shkresore) janë paraqitur denoncime të operatorëve të ndryshëm ekonomikë, të cilët kanë kundërshtuar veprimet e autoriteteve kontraktore në procedura të caktuara prokurimi, duke pretenduar për shkelje të dispozitave ligjore të prokurimit publik.

Denoncimet e operatorëve ekonomikë kanë qenë kryesisht për procedura prokurimi me vlerë të vogël, si procedura, të cilat nuk kanë proces ankimi dhe operatorët ekonomikë kanë parashtruar pretendimet e tyre për skualifikim të padrejtë.



Vlen të theksohet se, në mënyrë të vazhdueshme janë kontestuar nga operatorët ekonomikë, procedura prokurimi me vlerë të vogël, të cilat kanë pasur si objekt shërbimin e mbikqyrjes dhe kolaudimit të punimeve, ku janë parashtruar pretendime mbi mosrespektimin e legjislacionit në fuqi në përlllogaritjen e fondit limit dhe vlerësimin e ofertave ekonomike të paraqitura nga ofertuesit.

Gjatë vitit 2017, APP ka verifikuar denoncime për 12 procedura prokurimi, të zhvilluara nga 11 Autoritete Kontraktore.

Gjithashtu, kanë qenë subjekt monitorimi edhe 2 Autoritete Kontraktore, për 2 procedura prokurimi, raste, të cilat i janë përcjellë për kompetencë APP, nga Komisioni i Prokurimit Publik dhe Kontrollit i Lartë i Shtetit.

Në formë tabelore, të dhëna mbi monitorimet e kryera:

Procedura të monitoruara për periudhën Janar-Dhjetor 2017 Sipas tipit të kontratës		
Autoritete Kontraktore, subjekt monitorimi	39	
Vendime të APP	42	
Procedura prokurimi të monitoruara	Procedura për punë publike	12
	Procedura për mallra	16
	Procedura për shërbime	22
	Totali	50

Koment: Numri i Vendimeve të APP është më i lartë se numri i autoriteteve subjekt monitorimi, pasur në konsideratë faktin se një autoritet mund të jetë monitoruar më shumë se një herë

Procedura të monitoruara për periudhën Janar-Dhjetor 2017 Sipas llojit të procedurës	
Lloji i procedurës së prokurimit	Numri
Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	21
Procedurë e hapur	9
Kërkesë për propozim	5
Procedura prokurimi me vlerë të vogël	14
Shërbim konsulence	1
Totali	50



Autoritetete Kontraktore të monitoruara nga APP			
Nr.	Autoriteti	Nr.	Autoriteti
1.	Misioni Shqiptar në Gjenevë	21.	Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve
2.	Shtypshkronja e letrave me vlerë sh.a	22.	Ujësjiellës-Kanalizime sh.a Sarandë
3.	S.U.O.GJ “Mbretëresha Geraldinë”	23.	Drejtoria e Përgjithshme Nr. 3 e Punëtorëve të Qytetit
4.	Posta Shqiptare Sh.a.	24.	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura Tiranë
5.	Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë	25.	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
6.	Ujësjiellës Kanalizime Tiranë	26.	Spitali Psikiatrik “Sadik Dinci” Elbasan
7.	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	27.	Bordi Rajonal i Kullimit Durrës
8.	Bashkia Kamëz	28.	Drejtoria e Riparimit të Transformatorëve dhe Likuidimit të Avarive
9.	Bashkia Vau Dejës – Shkodër	29.	Drejtoria Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit, Tiranë
10.	Bashkia Librazhd	30.	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
11.	OSHEE Sh.a/Drejtoria Rajonale Fier	31.	Sha Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë
12.	Bordi Rajonal i Kullimit Fier	32.	Bashkia Berat
13.	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit	33.	Spitali Berat
14.	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	34.	Drejtoria e Shëndetit Publik Tepelenë
15.	Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Tiranë	35.	HEC Lana Bregas Sha
16.	Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor, Peshkopi	36.	Drejtoria e Shërbimit Spitalor, Kukës
17.	Sha Ujësjiellës Gramsh	37.	Bashkia Lushnje
18.	Bashkia Korçë	38.	Bashkia Mallakastër
19.	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë Tiranë	39.	Bashkia Prrenjas
20.	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare		

5.2. Shqyrtimi i raporteve të organeve audituese

Shqyrtimi i raporteve të organeve audituese, është një ndër aktivitetet kryesore të veprimtarisë së APP, të përcaktuara në Ligjin Nr. 9643/2006 “Për prokurimin publik”.



Mbi këtë bazë, gjatë vitit 2017, APP ka bashkëpunuar me institucionet audituese në vend, si: Kontrolli i Lartë i Shtetit, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria e Inspektimit Financiar dhe Audite të Brendshme të institucioneve, duke marrë në shqyrtim të gjitha raportet (*pjesët takuese, ku trajtohen gjetje për prokurimet e audituara*), të dërguara për kompetencë në APP, nga këto institucione.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, është komunikuar me këto institucione, në çdo rast kur ka pasur nevojë për plotësim të materialit të dërguar për shqyrtim në APP.

Gjatë shqyrtimit të çdo raporti auditues, APP ka respektuar të drejtën e subjektit të audituar/personave të evidentuar si përgjegjës nga organet audituese, për të paraqitur në APP, kundërshtimet e tyre mbi gjetjet e pasqyruara në raportet përkatëse.

APP ka konkluduar në vendimarrjen përfundimtare të trajtimit të raporteve audituese, pas shqyrtimit, analizimit dhe vlerësimit me kujdes, të çdo gjetje të pasqyruar në raport, nga institucioni auditues.

Gjatë vitit 2017, nga APP janë shqyrtuar 38 raporte auditimi, përkatësisht për **38 Autoritete Kontraktore** të audituara nga institucionet audituese.

APP ka shqyrtuar gjetjet për **314 procedura prokurimi**, si dhe gjetje për prokurime me vlerë të vogël, shtesa kontratash dhe problematika të përgjithshme të procesit të prokurimit në autoritetin kontraktor, të trajtuara në raportet e auditimit.

Në formë tabelore, **të dhëna mbi shqyrtimin e raporteve** të organeve audituese:

Raporte Auditimi të shqyrtuara sipas institucioneve Audituese	
Institucioni Auditues	Numri i raporteve
Kontrolli i Lartë i Shtetit	23
Audite të Brendshme të Institucioneve	5
Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	10
Totali	38

Raporte Auditimi të shqyrtuara sipas institucioneve të audituara	
Institucioni i audituar (qendror/vendor/varësie/sh.a.)	Numri i raporteve
Ministri	2
Spitale e drejtori rajonale spitalore	10
Njësi të qeverisjes vendore (Bashki), përfshi njësitë administrative (ish Komunat)	20
Institucione varësie të Ministrive dhe Sh.a.	6
Totali	38



Institucioni auditues	Autoriteti kontraktor	Institucioni auditues	Autoriteti kontraktor
Kontrolli i Lartë i Shtetit	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	Spitali Bulqizë
	Bashkia Bulqizë		Spitali Mallakastër
	Bashkia Shijak		Spitali Kukës
	Bashkia Devoll		Drejtoria e Shërbimit Spitalor, Berat
	Bashkia Këlcyrë		Spitali Rajonal Dibër
	Bashkia Dibër		Spitali Rajonal Korçë
	Këshilli i Qarkut Gjirokastrë		Spitali Vlorë
	Bashkia Librazhd		Spitali Mirditë
	Bashkia Sarandë		Spitali Mat
	Bashkia Peqin		Spitali Devoll
	Bashkia Cërrik	Audit i Brendshëm	Ministria e Zhvillimit Urban
	Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave		Drejtoria Vendore e Policisë Berat
	Bashkia Gramsh		Shtëpia e Foshnjës Durrës
	Bashkia Himarë		Shtypshkronja e Letrave me Vlerë
	Bashkia Patos		Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
	Bashkia Tepelenë		
	Bashkia Ura Vajgurore		
	Bashkia Roskovec		
	Bashkia Kavajë		
	Bashkia Fier		
	Bashkia Klos		
	Bashkia Pukë		
	Bashkia Tropojë		



5.3. Gjetjet dhe problematikat e evidentuara gjatë procesit të monitorimit

Gjatë procesit monitorues dhe shqyrtimit të raporteve audituese, janë konstatuar shkelje të ndryshme të dispozitave ligjore të prokurimit publik, nga autoritetet kontraktore që kanë zhvilluar procedurat e prokurimit të monitoruara nga APP apo institucionet auditues.

I. APP ka konstatuar në mënyrë të vazhdueshme mangësi dhe parregullsi në një nga fazat më të rëndësishme të procesit të prokurimit, atë të përlllogaritjes së fondit limit. Në pjesën dërrmuese të procedurave të prokurimit të monitoruara është vërejtur mungesa e argumentimit dhe dokumentimit nga autoriteti kontraktor, i përlllogaritjes së fondit limit të objektit përkatës të prokurimit.

Në dokumentacionin e administruar për një procedurë prokurimi, autoritetet kontraktore pasqyrojnë, në një procesverbal të mbajtur për këtë qëllim, mënyrën e përlllogaritjes së fondit limit, që në të shumtën e rasteve cilësohet se, bëhet nëpërmjet testimit të tregut apo duke u referuar në çmimet e kontratave të mëparshme, por nuk administrojnë dokumentacionin provues për çmimet e marra në konsideratë, ofertat e operatorëve ekonomikë të marra nga ky testim, kontratat përkatëse të mëparshme, si dhe çdo dokument tjetër ku është bazuar në çmimet referuese.

Kjo problematikë konstatohet më së shumti në procedurat e prokurimit për punë publike, ku në përlllogaritjen e fondit limit, autoritetet kontraktore nuk dokumentojnë referencat e çmimeve për njësi të përdorura dhe/ose nuk hartojnë analiza çmimi për zërat e punimeve, për të cilat nuk gjenden çmime në manualet përkatëse të çmimeve zyrtare.

Vërehet se, në disa raste, çmimet e përdorura në hartimin e preventivit dhe përlllogaritjen e fondit limit, nuk përputhen me çmimet në manualet përkatëse edhe pse si referenca shënohen numrat e analizave në këto manuale, duke sjellë kështu një rritje fiktive të vlerës së fondit limit.

Gjithashtu, në shumë raste, edhe pse Autoriteti Kontraktor ka hartuar analiza teknike për çmimet njësi të zërave, për të cilat nuk gjenden çmime në manualet përkatëse, nuk dokumentohen çmimet e nënçrave (materialeve, mjeteve, orëve të punës etj.) të përdorura në analizat përkatëse. Kjo gjë bën që një analizë e tillë të mos pasqyrojë të gjithë informacionin e plotë mbi referencat, në bazë të së cilave është përlllogaritur çmimi për njësi, rrjedhimisht dhe vlera e fondit limit.

Problematika në përlllogaritjen e fondit limit bëhet më e theksuar në rastet kur, ky proces realizohet nga subjekte të licencuara, jashtë autoritetit. Ky i fundit duke mos pasur struktura të specializuara, dhe në të shumtën e rasteve duke mos ngritur një grup të posaçëm për marrjen në dorëzim të projektit - preventivit përkatës, merr në përfundim një produkt, për të cilin nuk ka verifikuar paraprakisht, nëse preventivuesi ka respektuar legjislacionin në fuqi në hartimin e këtij preventivi. Për pasojë, rezulton të merren të mirëqenë nga Autoriteti Kontraktor, preventiva, të cilët mund të kenë çmime më të larta se çmimet e manualeve përkatëse.

Në shumë raste konstatohet se, subjekti i licencuar dorëzon vetëm preventivin dhe nuk e shoqëron atë, me analizat e çmimeve për çmimet njësi të zërave, për të cilat nuk gjenden çmime në manualet përkatëse. Për pasojë, rezulton që Autoriteti të përftojë, një preventiv ku vlera e punimeve është rritur fiktivisht nga rritja e çmimeve të zërave të veçantë, ose një preventiv ku nuk dokumentohet referenca e disa prej çmimeve njësi të përdorura për përlllogaritjen e fondit limit.

Gjatë vitit 2017, janë bërë evidente në mënyrë të përsëritur problematika në përlllogaritjen e fondit limit të shërbimeve të parashikuara në VKM Nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Sipas parashikimeve në këtë vendim, krahas përlllogaritjes së fondit limit (*i cili, përlllogaritet nisur nga përqindja maksimale e lejuar*), bëhet përlllogaritja e vlerës minimale të lejuar (*e cila, përlllogaritet nisur nga*



përqindja minimale e lejuar), në varësi të kategorisë dhe grupit tarifar ku bën pjesë objekti i prokurimit. Në VKM në fjalë përcaktohet qartë mënyra e përlllogaritjes së vlerës minimale të lejuar, si dhe fakti që nuk pranohen vlera më të ulëta (*me përjashtim të rasteve kur dokumentohet gjendja e jashtëzakonshme nga AK*), se vlerat që dalin nga përlllogaritjet e bëra mbi bazën e parashikimeve të kësaj VKM.

Në shumicën e rasteve të monitoruara, autoritetet kontraktore nuk përlllogarisin vlerë minimale për shërbimin objekt kontrate, në kundërshtim me sa parashikohet në legjislacionin në fuqi dhe rrjedhimisht, pranojnë oferta me vlerë më të ulëta se kjo vlerë.

Duke marrë shkas pikërisht nga problematika e evidentuar në monitorimet e kryera, APP, nëpërmjet një rekomandimi të hartuar dhe publikuar për këtë qëllim, udhëzoi autoritetet kontraktore që në prokurimin e shërbimeve në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim, të mbahen në konsideratë parashikimet e legjislacionit në fuqi, duke i orientuar konkretisht mbi mënyrën e procedimit në përlllogaritjen e fondit limit dhe vlerësimit të ofertave në procedurat e prokurimit për këto lloj shërbimesh.

II. Në lidhje me kriteret e pranimit, në mënyrë të vazhdueshme është konstatuar mungesa e argumentimit të kriterëve të veçanta të pranimit dhe mospërcaktimi i dokumentit konkret që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin në përmbushje të këtyre kriterëve.

Pavarësisht faktit që rregullat e prokurimit publik përcaktojnë detyrimin e autoriteteve kontraktore për të argumentuar domosdoshmërinë e vendosjes së çdo kriteri të veçantë pranimi, në raport me natyrën dhe përmasat e objektit konkret të prokurimit, dhe dokumentuar këtë, si një proces kyç që lidhet drejtpërdrejt me pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurë, ky detyrim nuk respektohet nga autoritetet.

Në shumicën e procedurave të monitoruara, por edhe gjatë shqyrtimit të raporteve të organeve audituese, APP ka konstatuar se këtij procesi nuk i jepet rëndësia e duhur.

Edhe në rastet kur, autoritetet kontraktore pretendojnë se, kanë respektuar detyrimin ligjor të sipërcituar, nëpërmjet mbajtjes së një procesverballi ku pasqyrohen kriteret e pranimit, në këtë procesverbal nuk pasqyrohen argumenta specifik, për të justifikuar përcaktimin e kriterit përkatës, duke analizuar natyrën e objektit të prokurimit dhe elementët konkretë të tij, në përputhje me kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik dhe të fushës së objektit që prokurohet.

Përveç sa më sipër, në mjaft raste është konstatuar se, autoritetet kontraktore nuk përcaktojnë dokumentat konkretë që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë, për të përmbushur kriteret e pranimit të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Në këtë mënyrë jo vetëm shkaktohet konfuzion për operatorët ekonomikë të interesuar, por edhe lihet mundësi për subjektivizëm dhe interpretim gjatë procesit të vlerësimit të ofertave.

- Sa i takon hartimit të kriterëve të veçanta të pranimit, APP ka konstatuar se autoritetet kontraktore hartojnë kritere pranimi, të cilat nuk janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e objektit që prokurohet, në kundërshtim me dispozitat ligjore, duke kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të interesuar.

Në çdo rast, nëpërmjet kriterëve të pranimit, synohet të krijohet bindja se operatori ekonomik zotëron kapacitetet e nevojshme ligjore, profesionale, ekonomike dhe teknike, për realizimin me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, autoriteti nuk mund të bëhet abuziv, duke përcaktuar kritere pranimi të panevojshme, të cilat bëhen pengesë për pjesëmarrjen e operatorëve të mundshëm ekonomikë që kanë të gjitha kapacitetet për realizimin e kontratës që prokurohet.



Një konstatim i vazhdueshëm i APP dhe institucioneve audituese, në procedurat e prokurimit për punë publike është se, autoritetet kontraktore kërkojnë rëndom si kriter kualifikimi, që ofertuesit të zotërojnë kategori licence, të cilat nuk përputhen me natyrën dhe vlerën e punimeve objekt kontrate dhe janë në kundërshtim me parashikimet e VKM Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Në shumë raste, autoriteti kontraktor në përcaktimin e kategorive të licensave, nisat nga vlera totale e preventivit dhe jo nga vlera e punimeve të së njëjtës natyrë, ndërkohë që, në çdo rast, kategoritë e licensave duhet të jenë në përputhje me vlerën e punimeve të së njëjtës natyrë.

- Një problematikë tjetër e përsëritur nga disa autoritete kontraktore është mospërcaktimi sipas rregullave të prokurimit publik i kriterit të kualifikimit lidhur me eksperiencën e ngjashme të mëparshme, të kërkuar nga operatorët ekonomikë. Konkretisht, në kundërshtim me këto rregulla, autoritetet nuk e specifikojnë kriterin në varësi të eksperiencës me sektorin publik apo privat, si dhe nuk bëjnë një ndarje të dokumentacionit përkatës të kërkuar për secilin sektor.

Veçanërisht në prokurimet për punë publike, për eksperiencën të ngjashme, autoritetet kontraktore kërkojnë që ofertuesit të kenë realizuar punë të njëjta me objektin e prokurimit, madje përcaktojnë edhe vlerën minimale të punimeve të veçanta që duhet të kenë realizuar ofertuesit.

Në çdo rast, sipas parashikimeve në dispozitat ligjore të prokurimit publik, Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë që ofertuesit të kenë përvojë të mëparshme të ngjashme, në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe nuk mund të përcaktojë zëra specifikë punimesh, në përmbushje të kriterit mbi përvojën e mëparshme.

- Problematike mbetet, gjithashtu, përcaktimi i numrit të punonjësve, të domosdoshëm për realizimin e objektit të kontratës dhe periudha kohore e kërkuar, për sigurimin e tyre.

Pothuajse në asnjë rast, autoritetet kontraktore nuk hartojnë analiza teknike të mirëfillta, për të justifikuar numrin e punonjësve të kërkuar, duke u nisur psh, nga grafiku i punimeve dhe orët e punës që duhen për të realizuar secilin prej zërave të preventivit. Për rrjedhojë, përcaktojnë një numër punëtorësh të paargumentuar, të panevojshëm dhe kufizues, dhe vetëm në momentin që konstatohet si mangësi fakti i sipërcituar, autoritetet kontraktore përpiqen të japin argumentime dhe “shpërndarje” të punëtorëve, sipas zërave të punimeve të parashikuara në preventiv apo objektit përkatës të prokurimit.

Përveç numrit të pajustificuar të punonjësve të kërkuar, vërehet se, periudha e sigurimit të këtyre punonjësve (*e cila, shkon deri në tre vjet nga koha e zhvillimit të tenderit*) është po ashtu e paargumentuar, kufizon pjesëmarrjen dhe nuk përmbush qëllimin, për të cilin kërkohet ky kriter. Vlen të theksohet se, e rëndësishme për autoritetin kontraktor, është të krijojë bindje se ofertuesi disponon numrin e punonjësve të kërkuar në kohën e ofertimit dhe në vijim për ekzekutimin e kontratës, ndërkohë që periudha tre vjeçare nga data e zhvillimit të procedurës, përveçse është element kufizues, nuk është tregues mbi disponueshmërinë e këtyre punonjësve në vijim, për realizimin e objektit të kontratës.

E njëjta problematikë evidentohet edhe në përcaktimin e llojit dhe të numrit të makinerive dhe mjeteve, në procedura për punë publike apo shërbime. Autoritetet kontraktore nuk hartojnë analiza teknike të mirëfillta, por përcaktojnë mjetet, duke u nisur nga emërtimi i zërave të punimeve dhe nuk analizohet secili zë, për të përcaktuar orët e punës dhe rrjedhimisht, numrin e mjeteve dhe makinerive të domosdoshme për realizimin e objektit të kontratës.



- Vlen të përmendet se, në disa raste, përgjithësisht në njësitë e qeverisjes vendore, është konstatuar se në kriteret e pranimit, kërkohet paraqitja e një dokumenti ku ofertuesi të provojë se nuk ka detyrime të pashlyera në këtë njësi. Ky dokument jo vetëm që është i panevojshëm, pasi vetë autoriteti kontraktor e disponon informacionin përkatës, por mund të bëhet pengesë për pjesëmarrje të operatorëve ekonomikë të interesuar për të ofertuar në procedurën konkrete të prokurimit.

III. Sa i takon procedurës së prokurimit “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, shkela kryesore e konstatuar nga APP, është përzgjedhja e gabuar e kësaj procedure, në kundërshtim me dispozitat ligjore të prokurimit publik. Për më tepër, Autoritetet Kontraktore nuk administrojnë dokumentacionin e nevojshëm për të provuar se, plotësojnë kushtet ligjore të përdorimit të kësaj lloji procedure, si dhe për të lejuar kontrollin e zbatimit të ligjit.

Konkretisht, ka rezultuar se, disa autoritete kontraktore përzgjedhin këtë procedurë prokurimi në vijim të dy procedurave të njëpasnjëshme, në të cilat ofertuesit nuk plotësojnë kriteret e kualifikimit.

Ndërkohë, sipas parashikimeve ligjore të prokurimit, kjo procedurë mund të zbatohet nga autoritetet kontraktore, vetëm në rastet kur, në dy procedura të njëpasnjëshme prokurimi nuk është siguruar konkurreca minimale. Pra, vërehet një keqinterpretim i legjislacionit të prokurimit publik, i cili çon në përzgjedhje të gabuar të procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, në këtë rast.

Për më tepër, nga hetimet administrative të kryera nga APP gjatë procesit monitorues, ka rezultuar se, autoritetet kontraktore nuk analizojnë shkaqet e mundshme, që kanë çuar në dështimin e procedurave të mëparshme të prokurimit, për të reflektuar dhe marrë masat e nevojshme në korrigjimin e tyre, si dhe nuk pasqyrojnë informacion nëse këto autoritete kanë kryer ndryshime në dokumentat e tenderit, sikurse kërkohet në ligj dhe në rregullat e prokurimit publik.

Nga monitorimet e kryera nga APP, rezulton se, kryesisht procedura “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” është përdorur nga Autoritetet Kontraktore me pretendimin se, ndodhen në kushte të nevojës ekstreme, për objektin që kërkohet të prokurohet.

Autoritetet kontraktore, nuk argumentojnë dhe provojnë plotësimin e kushteve ligjore për këtë rast, konkretisht, nuk justifikojnë rrethanat e paparashikuara, që i kanë çuar këto autoritete në pamundësi për të planifikuar në kohë nevojat e tyre, me qëllim përmbushjen e këtyre të fundit nëpërmjet procedurave konkurruese, sipas parashikimeve ligjore.

Në rastet kur, Autoriteti Kontraktor ka pasur mundësi të parashikojë në kohë nevojën përkatëse për objektin e prokurimit, por me mosveprimet e tij, ka sjellë “krijimin e një situatë emergjente”, përzgjedhja e procedurës së prokurimit “Negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, është konsideruar në shkelje të dispozitave ligjore për prokurimin publik.

Përveç përzgjedhjes së gabuar të kësaj lloji procedure, sikurse kemi analizuar më sipër, një tjetër shkelje e konstatuar nga APP, ka qenë lidhja e kontratave afatgjata, ndërkohë që legjislacioni në fuqi, përcakton në mënyrë të qartë mundësinë e përdorimit të kësaj procedure, vetëm për të zgjidhur situatat emergjente, duke ndaluar shprehimisht lidhjen e kontratave afatgjata.

IV. Sa i takon procesit të vlerësimit të ofertave të dorëzuara nga operatorët pjesëmarrës, në shumicën e rasteve është konstatuar shkelje e dispozitave ligjore të prokurimit publik, në kualifikimin e operatorëve që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit apo skualifikim të padrejtë të operatorëve ekonomikë, të cilët plotësojnë kriteret ose mund të kenë devijime të vogla, që nuk i ndikojnë vlefshmërisë së ofertës. Madje, në disa raste në trajtimin e raporteve audituese, evidentohet veprim i autoritetit me dy standarde në vlerësimin e ofertuesve.



APP ka konstatuar raste të pjesëmarrjes së bashkimit të operatorëve ekonomikë, ku në marrëveshjet respektive të bashkëpunimit nuk janë përcaktuar elementët konkretë të punëve, furnizimeve apo shërbimeve që do të kryejë secili prej operatorëve për kontratën përkatëse, duke e bërë objektivisht të pamundur vlerësimin e drejtë të këtij bashkimi në ato raste kur autoriteti nuk ka kryer sqarimet e nevojshme. Për pasojë, gjendemi përballë një vlerësimi jo real nga autoriteti kontraktor, të ofertës së bashkimit të operatorëve në këto raste.

Gjithashtu, lidhur me vlerësimin e ofertave, janë konstatuar raste kur për shkak të përcaktimit të një kriteri pranimi, i cili lidhet me informacion që disponohet nga vetë autoriteti, ky i fundit skualifikon ofertuesin, i cili nuk paraqet dokumentin e kërkuar, megjithëse ka gjithë mundësitë e verifikimit të këtij informacioni.

Në procedurat e prokurimit për punë publike, në disa raste, edhe pse në kriteret e kualifikimit është kërkuar realizimi me sukses i punëve të ngjashme, konstatohet se autoritetet kontraktore skualifikojnë ofertuesit me pretendimin se, në preventivat e punëve të ngjashme të realizuara nga këta ofertues nuk kanë të njëjtat zëra punimesh me preventivin objekt prokurimi, ose raportet e zërave të njëjtë nuk janë përpjestimore në lidhje me vlerën totale të punimeve.

- Mungesa e dokumentimit nga autoritetet për verifikimin e dokumentacionit origjinal të operatorit ekonomik fitues është një mangësi e konstatuar disa herë gjatë procesit të monitorimit. Edhe pse autoritetet kryejnë verifikimin fizik të dokumenteve të paraqitura nga operatori fitues, ky verifikim duhet të dokumentohet me shkrim dhe të bëhet pjesë e dosjes së procedurës së prokurimit.
- Në disa raste, APP ka konstatuar se, autoritetet kanë pranuar një sigurim kontrate më të ulët se 10% të vlerës së saj, në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, të cilat shprehimisht kërkojnë nga ofertuesi fitues sigurimin e kontratës prej 10% të vlerës së saj.

Vlen të theksohet se, gjatë monitorimit të procedurave të prokurimit dhe gjatë shqyrtimit të raporteve të institucioneve audituese, APP ka analizuar shkeljet e kryera nga autoritete të ndryshme kontraktore dhe ka udhëzuar këto autoritete për veprimet në pajtim me legjislacionin e prokurimit publik, që duhet të kryejnë në procedura të tjera prokurimi.

5.4. Masat Administrative

Në përfundim të procesit të monitorimit, dhe shqyrtimit të raporteve të organeve audituese, në rastet kur janë konstatuar shkelje të legjislacionit të prokurimit publik në fuqi, APP në varësi të llojit të shkeljes, fondit limit të procedurave të prokurimit, rolit të personit në këto procedura, si dhe pasojës së ardhur, ka marrë vendim për dënim me gjobë ose ka propozuar marrjen e masës disiplinore, ndaj personave përgjegjës, sipas parashikimeve të nenit 72 të LPP.

- Nga hetimet administrative të kryera nga APP, për **43 Autoritete Kontraktore**, është konkluduar për **masa administrative, konform parashikimeve ligjore në 42 Autoritete Kontraktore**, ndërkohë që në **1 autoritet kontraktor është mbyllur hetimi administrativ**, duke vlerësuar se nuk provohet shkelje e dispozitave ligjore të prokurimit.



Të dhënat statistikore mbi masat administrative të vendosura nga APP, në përfundim të procesit të monitorimit, paraqiten në vijim:

Statistika mbi masat administrative nga procesi i monitorimit sipas numrit të punonjësve	
Masa Administrative	Numri i punonjësve
Gjobë	111
Propozim për masë disiplinore	103

Nisur nga roli i personit në procedurën e prokurimit të monitoruar, të dhënat sipas numrit të autoriteteve kontraktore:

Monitorimi Dënime me gjobë sipas rolit të zyrtarit	
Roli i zyrtarit	Numri i Autoriteteve Kontraktore
Titullar i Autoritetit Kontraktor	9
Anëtar i Njesisë së Prokurimit	16
Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave	14
Anëtar i Grupit për Përlllogaritjen e Fondit Limit	4

Monitorimi Propozime për Masa Disiplinore sipas rolit të zyrtarit	
Roli i zyrtarit	Numri i Autoriteteve Kontraktore
Titullar i Autoritetit Kontraktor	3
Anëtar i Njesisë së Prokurimit	10
Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave	8
Anëtar i Grupit për Përlllogaritjen e Fondit Limit	8
Anëtar i Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël	11

- Nga raportet e organeve audituese të shqyrtuara nga APP, për **38 Autoritete Kontraktore**, është konkluduar për **masa administrative, konform parashikimeve ligjore në 37 Autoritete Kontraktore**, ndërkohë që në **1 autoritet kontraktor** është vlerësuar se, nuk provohet shkelje e dispozitave ligjore të prokurimit.

Të dhënat statistikore mbi masat administrative të vendosura nga APP, në përfundim të shqyrtimit të raporteve të organeve audituese, paraqiten në vijim:

Statistika mbi masat administrative nga shqyrtimi i raporteve audituese sipas numrit të punonjësve	
Masa Administrative	Numri i punonjësve
Gjobë	391
Propozim për masë disiplinore	127



Nisur nga roli i personit në procedurat e prokurimit të audituara, të dhënat sipas numrit të autoriteteve kontraktore:

Shqyrtimi i raporteve audituese Dënime me gjobë sipas rolit të zyrtarit	
Roli i zyrtarit	Numri i Autoriteteve Kontraktore
Titullar i Autoritetit Kontraktor	8
Anëtar i Njësisë së Prokurimit	22
Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave	25
Anëtar i Grupit për Përlllogaritjen e Fondit Limit	11
Anëtar i Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël	2

Masa Disiplinore

Shqyrtimi i raporteve audituese Propozime për Masa Disiplinore sipas rolit të zyrtarit	
Roli i zyrtarit	Numri i Autoriteteve Kontraktore
Titullar i Autoritetit Kontraktor	9
Anëtar i Njësisë së Prokurimit	24
Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave	7
Anëtar i Grupit për Përlllogaritjen e Fondit Limit	3
Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël	6



6. TREGUESIT E VEPRIMTARISË PËR TEKNOLOGJINË E INFORMACIONIT DHE PUBLIKIMIN

6.1. Sektori i Publikimeve

Sektori i Publikimeve gjatë vitit 2017 ka publikuar në total 52 Buletine të Njoftimeve Publike me një numër faqesh në total prej 24.109, ose mesatarisht 464 faqe për javë.

Përveç punës për përmbledhjen e informacionit për publikimin e Buletinit të Njoftimeve Publike punonjësit e ngarkuar me kryerjen e publikimit kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në miratimin e njoftimeve të kontratave të hedhura nga Autoritetet Kontraktore, me qëllim publikimin e tyre në sistemin e prokurimit elektronik.

Konkretisht, gjatë vitit 2017 janë miratuar për publikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe janë publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike:

Njoftime për Procedura

- 7317 Njoftime Kontratash të koordinuara dhe me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave të prokurimit, duke reflektuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vetëm njoftimet për të cilat janë respektuar afatet e ankimit;
- 61 Njoftime për Marrëveshje Kuadër;
- 4,790 Njoftime Fituesi të koordinuara dhe me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave të prokurimit, duke reflektuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vetëm njoftimet për të cilat janë respektuar afatet e ankimit;
- 36 Njoftime për Marrëveshje Kuadër të nënshkruara;
- 4,749 Njoftime Kontratash të Nënshkruara për procedura të kryera në Sistemin e Prokurimit Elektronik;
- 2,234 Njoftime Kontratash të Nënshkruara për procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, përfshi këtu edhe shtesat e kontratave, për plotësimin e nevojave në fillim të vitit 2017;
- 433 Njoftime Kontratash të Nënshkruara (minikontrata) brenda Marrëveshjeve Kuadër;
- 2428 Njoftime Anullimi të koordinuara dhe me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave, duke reflektuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vetëm njoftimet për të cilat janë respektuar afatet e ankimit.
- 2,086 Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave të prokurimit në fazë të ndryshme, duke reflektuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vetëm njoftimet për të cilat janë respektuar afatet e ankimit.

Të detajuara këto (2086) Vendime të Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2017 janë:

- 677 pezullime fillestare të procedurave të prokurimit,
- 89 vendime anulimi,
- 1320 vendime modifikimi, pezullimi të ndërmjetëm, rivlerësimi dhe lejimi.



Njoftime për Ankande Publike

- 518 Njoftime për Ankandet publike të zhvilluara nga Autoritetet Shitëse;
- 163 Njoftime Fituesish për Ankandet publike të zhvilluara nga Autoritetet Shitëse;
- 47 Njoftime Kontratash të Nënshkruara për Ankandet publike të zhvilluara nga Autoritetet Shitëse;
- 225 Njoftime Anullimi për Ankandet publike të zhvilluara nga Autoritetet Shitëse;
- 335 Njoftime Ankandesh për efekt të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore;
- 77 Njoftime për qera.

Njoftime për Koncesione/Partneritet Publik Privat

- 25 Jane Njoftime Kontratash për Procedura Koncesioni;
- 15 Jane Njoftime Fituesish për Procedura Koncesioni;
- 2 Njoftime Kontratash të Nënshkruara për Procedura Koncesioni;
- 53 Njoftime për Procedura konkurruese për dhënie leje minerare;
- 1,216 Njoftime të tjera.


Gjithashtu, gjatë vitit 2017 janë përpunuar rreth 3,224 regjistra, për parashikimin e prokurimeve, realizimin e tyre dhe ndryshimet gjatë vitit nga Autoritetet Kontraktore, në funksion të përpunimit të të dhënave dhe nxjerrjes së statistikave përkatëse.

6.2. Sektori i teknologjisë së informacionit

Gjatë vitit 2017, për APP me një rëndësi të vecantë konsiderohet përfundimi me sukses i kontratës me objekt *“Ri-inxhinierim dhe shtim i funksionaliteteve/shërbimeve në sistemin e prokurimit elektronik mbështetur nga një teknologji dhe infrastrukturë e re”*, me anë të së cilës, është realizuar infrastrukturë hardware e re, dhe është kryer përmirësimi dhe shtimi i disa funksionaliteteve të reja për Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij procesi ishte dhënia e një perceptimi të ri për Sistemin e Prokurimit Elektronik, duke përmirësuar ndjeshëm performancën, duke ofruar shërbime të reja nëpërmjet portalit e-Albania dhe aplikacionin mobile “E-prokurim Albania”, si edhe duke ngritur në një shkallë më të lartë monitorimin dhe sigurinë e tij.

Sistemi i Prokurimit Elektronik, si rezultat i ri-inxhinierimit dhe përmirësimit bazohet në arkitekturën e mëposhtme për të ofruar funksionalitetin e tij në një performancë maksimale. Kjo arkitekturë është në nivel të lartë të komponentëve kryesorë të sistemit e parë nga këndvështrimi i përdorimit të sistemit.



Gjatë këtij procesi është realizuar me sukses:

- Ri-inxhinierimi i strukturës së të dhënave dhe ngritja e platformës aktuale të sistemit (framework) në versionet më të reja me qëllim rritjen e performancës së Sistemit të Prokurimit Elektronik dhe shmangien sa më shumë të incidenteve që vijnë për shkak të saj;
- Krijimi i Regjistrave të Parashikimeve dhe Realizimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik me qëllim lehtësimin e punës për autoritetet kontraktore, duke u dhënë atyre mundësinë e hedhjes online të të dhënave pa qenë e nevojshme dërgimi i tyre në rrugë shkresore dhe CD në APP;
- Shtimi i shërbimeve elektronike në platformën e-Albania për rritjen e transparencës dhe notifikimin e përdoruesve (publikë/operatorë ekonomikë) për llojet e tenderave që publikohen;
- Lançimi i aplikacionit mobile për platformat kryesore iOS dhe Android dhe mundësimi i ofertimit për procedurat me blerje të vogël me anë të tij për operatorët ekonomikë;
- Krijimi i një sistemi dhe infrastrukture arkivimi për procedurat e përfunduara;
- Krijimi i një sistemi “Business Intelligence” për raportime dhe analiza komplekse;
- Krijimi i një infrastrukture testimi, duke krijuar kushtet për punë metodike gjatë ndërhyrjeve apo zhvillimeve;
- Krijimi i një infrastrukture për “Business Continuity” në mjediset e APP, ndërkohë që Production është vendosur në mjediset e AKSHI-t.
- Përmirësimi i ndjeshën për çdo rol të përdoruesve në sistemi dhe shtimi i funksionaliteteve që mungonin dhe krijonin vështirësi në ecurinë normale të punës;



Gjithashtu, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit është bërë instalimi dhe konfigurimi i agentit të Audit Vault, si dhe në serverat e databazës, duke mundësuar kështu monitorimin e plotë të sistemit me Audit Vault.

6.2.1. Objektivat e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit

Sektori i Teknologjisë së Informacionit ka punuar maksimalisht në ofrimin e shërbimeve me siguri të lartë për të gjithë Autoritetet Kontraktore, Operatorët Ekonomikë, Audituesit, si dhe çdo Autoritet tjetër që, në përmbushje të detyrave të tij, përdor Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Objektivat kryesore për Sektorin e Teknologjisë së Informacionit gjatë vitit 2017 kanë qenë si më poshtë:

- Garantimi në kohë dhe me cilësi i ecurisë së punës për të gjithë përdoruesit e Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE) dhe Sistemit të Arkivës Elektronike (SAE).
- Zgjidhja e problematikave të ndryshme hardware dhe software, gjatë punës së përditshme duke garantuar ecurinë normale të prokurimit elektronik.
- Përmirësimi i vazhdueshëm dhe optimizimi i ndërfaqes, me qëllim përmirësimin dhe lehtësimin e punës së përdoruesve.
- Garantimi i siguri fizike të SPE dhe SAE në ambientet e caktuara. Në këtë kuptim, të gjitha asetet e informacionit të APP mbrohen në shkallën më të lartë nga dëmtimet fizike. Rrjeti informatik u nënshtrohet rregullave për sigurimin fizik të informacionit, të përcaktuara në Planin e Sigurisë së rishikuar.
- Garantimi i konfidencialitetit të ofertës ekonomike duke bërë enkriptimin dhe dekriptimin çka ka bërë që Informacioni me ndjeshmëri të lartë të jetë i përdorshëm vetëm për ata persona që janë të autorizuar ta shohin ose ta përdorin atë.
- Pasurimi i portalit të APP, me informacion të përditësuar në lidhje me procesin e prokurimit, nëpërmjet publikimit të 52 buletinëve javorë, publikimit të legjislacionit të përditësuar, vendimeve, udhëzimeve, raporteve, moduleve të trajnimit, monitorimeve, regjistrave të parashikimeve, realizimeve etj, në total 141 dokumenta, publikimi i 27 njoftimeve të ndryshme të aspektit teknik, në lidhje me funksionimin e sistemit.
- Sigurimi i back-up ditor, javor dhe mujor i Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE) dhe Sistemit të Arkivës Elektronike (SAE), si dhe ruajtja tek AKSHI.
- Garantimi i asistencës teknike për çdo kërkesë (kërkesat për dekriptim dokumentash, kërkesat për zëvendësim të anëtarëve të KVO, kërkesat për sqarim, ankesat nga ana teknike), të mbërritura në APP.
- Garantimi i asistencës teknike për punonjësit e APP-së.
- Garantimi i asistencës teknike për telefonatat dhe e-maillet e mbërritura në APP.
- Hartimi i specifikimeve teknike për kontratat që APP do të lidhë me të tretët.
- Krijimi, azhurnimi, si dhe mbyllja e llogarive të administratorit për Autoritetet Kontraktore. Për vitin 2017 janë shtuar 24 Autoritete Kontraktore të reja që përdorin Sistemin e Prokurimit Elektronik.



- Krijimi, azhurnimi, si dhe mbyllja e llogarive të përdoruesit për Autoritetet Kontraktore si dhe Audituesit.
- Krijimi, azhurnimi, si dhe mbyllja e llogarive të përdoruesit për Operatorët Ekonomikë.
- Monitorimi i procedurave të prokurimit të lëna pezull në sistem dhe publikimi i njoftimeve në portal për finalizimin e tyre nga nëpunësit e autorizuar.
- Monitorimi i sistemit të back up në tape në mënyrë që të rritet siguria e ruajtjes së të dhënave si dhe hartimi dhe zbatimi me përpikmëri i protokollit të ruajtjes së tape-ve.
- Pasqyrimi i përjashtimeve të operatorëve ekonomikë në portalin e APP.
- Arkivimi i të gjitha procedurave të lëna pezull nga Autoritetet Kontraktore. Ky proces bën të mundur që sistemi operacional, në të cilin kryhen të gjitha procedurat e prokurimit publik, të lehtësohet ndjeshëm duke ulur gjithmonë e më shumë numrin e procedurave që ndodhen në të dhe, për pasojë, duke lehtësuar punën e përdoruesve të sistemit (Autoritete Kontraktore, Operatorë Ekonomikë, Auditues).
- Garantimi i asistencës teknike për llogari audituese për çdo auditues të Autoriteteve Kontraktore si dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit.
- Zbatimi i detyrimeve në kuadër të bashkëpunimit me organizatat e tjera ndërkombëtare.
- Garantimi i trajnimeve për institucionet qendrore dhe vendore në fushën e prokurimit publik në fushën e IT.
- Monitorimi i kontratës së mirëmbajtjes për Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dhe Sistemin e Arkivës Elektronike (SAE).

6.2.2. Garantimi në kohë dhe me cilësi i ecurisë së punës për të gjithë përdoruesit e Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE) dhe Sistemit të Arkivës Elektronike (SAE).

Spektori i Teknologjisë së Informacionit është përpjekur maksimalisht, për të mbajtur “online” Sistemin e Prokurimit Elektronik, 24 orë në 7 ditë të javës, përveç rasteve kur nxjerrja e tij “offline” për një periudhë shumë të kufizuar, ka qenë e nevojshme për kryerjen e shërbimeve përkatëse, apo shtimin e funksionaliteteve të reja dhe paralajmërohet me anë të një njoftimi, pa cenuar në asnjë moment afatet e procedurave të prokurimit.

Rezultati i punës së Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit ka qenë administrimi i sigurt i një totali baze të dhënash prej:

7.97 TB (1,974,481,362,944 byte) të Sistemit të Prokurimit Elektronik,
 11.68 TB (11,684,030,087,168 byte) të Sistemit të Arkivës Elektronike dhe
 1.89 TB (1,894,908,656,128 byte) të Sistemit të Arkivës të re Elektronike.



Tabela e kapaciteteve të bazës së të dhënave sipas viteve:

Nr	Viti	2015	2016	2017
1	Sistemi i Prokurimit Elektronik (në bytes)	767,777,769,984	1,077,337,918,976	1,974,481,362,944
2	Arkiva Elektronike (në bytes)	8,718,846,291,456	11,211,277,434,880	11,684,030,087,168
3	Arkiva e Re Elektronike (në bytes)	0	0	1,894,908,656,128
	<i>Totali (në bytes)</i>	<i>9,486,624,061,440</i>	<i>12,288,615,353,856</i>	<i>15,553,420,106,240</i>
	Totali (në Terabyte)	9.49	12.29	15.55

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet kapaciteti i bazës së të dhënave për Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe Sistemin e Arkivës Elektronike në TB.



6.2.3. Dhënia e asistencës teknike brenda dhe jashtë APP

Mbështetja teknike që u jepet të gjitha autoriteteve kontraktore, si dhe të gjithë operatorëve ekonomikë të huaj dhe vendas, të cilët përdorin sistemin e prokurimit elektronik, nëpërmjet e-mail-eve, telefonit apo dhe konsultimeve në ambientet e APP, është një nga detyrat kryesore të sektorit. Kështu, gjatë vitit 2017, janë përgatitur 2332 shkresa në total, sidomos në lidhje me:

- Shkresa për Krijim/ Mbyllje llogarie në rolin CA Admin dhe Operator Ekonomik, si dhe rikthim fjalëkalimi në gjendje fillestare;
- Shkresa sqaruese për Autoritetet Kontraktore dhe Operatorët Ekonomikë;
- Shkresa për dërgim të dhënash dhe bashkëpunim me institucionet e tjera;



Janë dërguar në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Monitorimit rreth 4000 e-maile në total, drejt:

- operatorëve ekonomikë (për konfirmimin e regjistrimeve të bëra online, për rikthim të fjalëkalimit në gjendjen fillestare, për sqarime, udhëzime dhe ankesa);
- autoriteteve kontraktore (për sqarime dhe udhëzime të karakterit teknik);
- institucioneve të tjera (për dërgim të dhënash dhe informacionesh);

Dhënia e asistencës teknike nga ky sektor është bërë edhe nëpërmjet trajnimeve të ndryshme, të organizuara nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Shkolla e Administratës Publike, ku specialistë të IT, kanë mbuluar sesionet mbi përdorimin e Sistemit Elektronik të prokurimeve.

Bashkëpunimi i Drejtorisë së IT-së me Drejtorinë Juridike dhe të Monitorimit ka qenë shumë produktiv edhe për sa i përket evidentimit të rasteve problematike dhe zgjidhjen e tyre, si dhe në përmirësimin e sistemit të prokurimit elektronik, konform legjislacionit në fuqi.

Një nga detyrat e përditshme të Sektorit të IT-së konsiston edhe në suportin e përdoruesve brenda APP, si dhe në menaxhimin e infrastrukturës së rrjetit të brendshëm kompjuterik dhe telefonik.


6.2.4. Krijimi i përdoruesve të rinj për vitin 2017

Për vitin 2017 në sistemin e prokurimit elektronik janë krijuar 2414 llogari përdoruese të rinj, dhe përkatësisht:

Nga Sektori i Teknologjisë së Informacionit gjatë vitit 2017 janë krijuar 24 llogari të reja në rolin "Administrator i Sistemit" për Autoritetet Kontraktore në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Ndërsa, nga llogaritë e Administratorëve të Autoriteteve Kontraktore janë krijuar në total rreth 2,390 llogari përdorues të rinj për rolet e njësisë së prokurimit, KVO dhe audituesit.

Në tabelën dhe në grafikun e mëposhtëm paraqitet numri i përdoruesve të Sistemit të Prokurimit Elektronik, brenda Autoriteteve Kontraktore, të krijuar përkatësisht në vitin 2017.

Viti	2017											
Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Novendor	Dhjetor
Numri i përdoruesve të rinj	230	359	296	237	258	138	154	115	131	162	172	138



Nga figura shihet qartë se numri më i madh i përdoruesve është krijuar në periudhën Janar - Maj, e cila është dhe periudha kur është e përqendruar shpallja e procedurave të reja.

Gjithashtu, nisur nga rekomandimet e lëna nga i Kontrolli i Lartë i Shtetit janë krijuar skedarë të rinj për përdoruesit joaktivë, në mënyrë që të bëhet e mundur identifikimi i saktë përdoruesve në sistem.

Në këto kushte, në sistem aktualisht rezultojnë rreth 15953 llogari përdoruesi në rolin e njësisë së prokurimit, anëtarë të KVO, auditues etj në statusin joaktiv dhe 8546 llogari përdoruesi në rolin e njësisë së prokurimit, anëtarë të KVO, audituesit në statusin aktiv. Ndërsa, në rolin e Administratorit të Sistemit për autoritetin kontraktor janë 932 në statusin joaktiv dhe 1378 në statusin Aktiv.

Tabela e mëposhtme paraqet statusin i llogarive të përdoruesve nga Autoritet Kontraktore në Sistemin e Prokurimit Elektronik:

Viti 2017		
Nr.	Roli i llogarive të Përdoruesve	Numri i llogarive
1	Përdorues Aktiv (njësi prokurimi, KVO, Auditues të AK)	8546
2	Përdorues joAktiv (njësi prokurimi, KVO, Auditues të AK)	15951
3	Administratorit të Sistemit për AK Aktiv	1378
4	Administratorit të Sistemit për AK JoAktiv	932



Përsa i përket, llogarive të përdoruesve në rolin e operatorëve ekonomikë, për vitin 2017 në Sistemin e Prokurimit Elektronik janë regjistruar **18412** operatorë ekonomikë të rinj, nga të cilët **75** janë operatorë ekonomikë të huaj.

Pajisja e operatorëve ekonomikë me llogari përdoruesi kryhet nga APP, si dhe falë shërbimit të ndërveprimit me sistemin e Qendrës Kombëtare e Biznesit, ku automatikisht çdo operator ekonomik i regjistruar në QKB pajiset me llogari përdoruesi në SPE.

Nr.	Operatorë ekonomike të regjistruar gjatë vitit 2017	
1	Operatorë Ekonomik të regjistruar në QKB	18336
2	Operatorë të huaj	75
Totali		18412

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet numri i Operatorëve Ekonomikë të rinj të Sistemit të Prokurimit Elektronik, të ardhur nga QKB, si dhe të regjistruar nga APP sipas Muajve:





6.2.5. Statistika të tjera në lidhje me përdorimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik


6.2.5.1. Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve


Në Sistemin e Prokurimit Elektronik, për vitin 2017 në total kemi 339,650,939 klikime, 270,884,661 shikime të faqes së internetit si dhe 1,502,361 vizitor.

Klikimet për vitin 2017

Klikimet Total	339,650,939
Klikimet sipas Vizitor	338,714,046
Mesatarja Klikimet ne dite	930,550
Mesatarja Klikimet per Vizitor	225.45
Shikimet e faqes	
Shikimet e faqes Total	270,884,661
Mesatarja e Shikimeve te faqes ne dite	742,149
Mesatarja e Shikimeve te faqes per Visitor	180.31
Total Visitors	1,502,361
Mesatarja Visitors per Day	4,116
Total Unique IPs	91,762

Daily Visitors






Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, piku i shpërndarjes së klikimeve dhe vizitorëve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, është gjatë periudhës Prill - Tetor.

6.2.5.2. Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas 24 orëve.

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm pasqyrohet shpërndarja e klikimeve, vizitorëve dhe kohës së shpenzuar sipas 24 orëve:

Hour	Hits	Page Views	Visitors
00:00 - 00:59	1,227,412	904,004	8,251
01:00 - 01:59	840,557	598,421	14,432
02:00 - 02:59	730,322	515,855	5,388
03:00 - 03:59	677,422	485,621	4,913
04:00 - 04:59	725,164	492,288	5,578
05:00 - 05:59	993,811	686,415	8,983
06:00 - 06:59	2,432,954	1,673,372	27,881
07:00 - 07:59	14,730,389	10,734,185	133,420
08:00 - 08:59	31,061,291	24,221,277	167,042
09:00 - 09:59	39,362,314	31,652,345	147,406
10:00 - 10:59	40,097,470	32,419,337	130,667
11:00 - 11:59	38,437,243	30,863,265	121,078
12:00 - 12:59	34,280,518	28,360,293	117,937
13:00 - 13:59	32,146,817	26,585,769	111,623
14:00 - 14:59	29,655,269	24,226,632	102,602
15:00 - 15:59	22,216,655	17,745,659	77,336
16:00 - 16:59	12,931,726	10,268,476	59,188
17:00 - 17:59	9,032,634	7,172,522	51,364
18:00 - 18:59	7,248,970	5,706,720	46,920
19:00 - 19:59	5,833,298	4,419,539	44,335
20:00 - 20:59	5,043,383	3,760,891	40,449
21:00 - 21:59	4,342,303	3,226,062	35,489
22:00 - 22:59	3,385,066	2,524,409	25,518
23:00 - 23:59	2,217,951	1,661,304	14,561
Total	339,650,939	270,884,661	1,502,361




Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, piku i shpërndarjes së klikimeve dhe vizitorëve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, është gjatë orarit 8:00-16:00.

6.2.5.3. Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas ditëve të javës.

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm pasqyrohet shpërndarja e klikimeve, vizitorëve dhe kohës së shpenzuar sipas ditëve të javës:

Day	Hits	Page Views	Visitors
Sunday	8,176,344	5,925,346	69,335
Monday	62,961,809	50,069,957	281,798
Tuesday	65,473,489	51,984,847	279,634
Wednesday	64,313,118	51,644,536	273,855
Thursday	64,943,477	51,814,711	262,795
Friday	56,165,140	45,215,889	234,705
Saturday	17,617,562	14,229,375	100,239
Total	339,650,939	270,884,661	1,502,361




Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, piku i shpërndarjes së klikimeve dhe vizitorëve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, gjatë javës është nga e Hëna në të Premte.



6.2.5.4. Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas muajve të vitit.

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm pasqyrohet shpërndarja e klikimeve, vizitorëve dhe kohës së shpenzuar sipas muajve:

Month	Hits	Page Views	Visitors
Jan 2017	3,203,304	1,727,525	659
Feb 2017	5,675,551	2,221,218	2,429
Mar 2017	1,633,682	811,594	4,512
Apr 2017	42,634,322	33,930,671	214,838
May 2017	50,463,423	39,422,811	202,059
Jun 2017	38,724,838	30,722,297	167,270
Jul 2017	30,090,183	24,719,299	147,654
Aug 2017	26,817,944	22,118,146	137,097
Sep 2017	31,043,517	25,726,828	148,603
Oct 2017	34,937,860	28,926,899	161,804
Nov 2017	37,898,657	30,994,081	158,840
Dec 2017	36,527,658	29,563,292	156,596
Total	339,650,939	270,884,661	1,502,361




Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, piku i shpërndarjes së klikimeve dhe vizitorëve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, është nga Muaji Shkurt deri në muajin Qershor dhe më pas periudha Shtator – Nëntor.



6.2.5.5. Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas qyteteve kryesore.


Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm pasqyrohet aktiviteti i përdoruesve sipas Qyteteve:




Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, përdoruesit kryesorë të Sistemit të Prokurimit Elektronik janë nga qytetet kryesore të Shqipërisë si Tiranë, Elbasan, Durrës, etj.

6.2.5.6. Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas shteteve.


Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm pasqyrohet shpërndarja e klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas shteteve:





Most Active Countries

	Country	Hits	Visitors	% of Total Visitors	Bandwidth (KB)
1	Albania	317,176,855	1,344,405	89.49%	0
2	Turkey	14,368,741	38,263	2.55%	0
3	Serbia	994,652	30,335	2.02%	0
4	Germany	2,159,564	13,253	0.88%	0
5	Italy	1,380,901	9,170	0.61%	0
6	France	331,773	7,115	0.47%	0
7	Russian Federation	161,502	6,979	0.46%	0
8	China	75,663	8,096	0.41%	0
9	Netherlands	419,391	5,205	0.35%	0
10	Greece	641,788	4,422	0.29%	0
11	United Kingdom	97,219	3,161	0.21%	0
12	Croatia	25,715	3,061	0.20%	0
13	Slovenia	108,287	2,515	0.17%	0
14	Montenegro	69,856	1,896	0.13%	0
15	Canada	22,394	1,750	0.12%	0
16	Macedonia	168,006	1,647	0.11%	0
17	Poland	61,641	1,354	0.09%	0
18	India	8,325	1,335	0.09%	0



Most Active Countries

	Country	Hits	Visitors	% of Total Visitors	Bandwidth (KB)
1	Albania	317,176,855	1,344,405	89.49%	0
2	Turkey	14,368,741	38,263	2.55%	0
3	Serbia	994,652	30,335	2.02%	0
4	Germany	2,159,564	13,253	0.88%	0
5	Italy	1,380,901	9,170	0.61%	0
6	France	331,773	7,115	0.47%	0
7	Russian Federation	161,502	6,979	0.46%	0
8	China	75,663	8,096	0.41%	0
9	Netherlands	419,391	5,205	0.35%	0
10	Greece	641,788	4,422	0.29%	0
11	United Kingdom	97,219	3,161	0.21%	0
12	Croatia	25,715	3,061	0.20%	0
13	Slovenia	108,287	2,515	0.17%	0
14	Montenegro	69,856	1,896	0.13%	0
15	Canada	22,394	1,750	0.12%	0
16	Macedonia	168,006	1,647	0.11%	0
17	Poland	61,641	1,354	0.09%	0
18	India	8,325	1,335	0.09%	0



Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, interesi kryesor për pjesëmarrjen në prokurimet publike në Republikën e Shqipërisë vjen nga operatorët ekonomikë të shteteve fqinje kryesisht nga Italia.



6.2.5.7. Aktiviteti i përdoruesve sipas ndërfaqeve më të klikuara në portalin e APP.

Tabela dhe Grafikët e mëposhtëm pasqyrojnë ndërfaqet më të kërkuara në internet për aksesimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik:

	Page	Visitors
1	http://www.app.gov.al/	1,078,248
2	http://www.app.gov.al/ ASP.Net/System/PortalService.aspx/ Ping/	77,807
3	http://www.app.gov.al/ e-prokurim/	72,977
4	http://www.app.gov.al/ GetData/DownloadDoc/	32,317
5	http://www.app.gov.al/ ASP.Net/System/ScriptModuleService.aspx/ ResolveTabHandler/	31,475
6	http://www.app.gov.al/ GetData/DownloadDocument/	26,149
7	http://www.app.gov.al/ ASP.Net/System/Notify/ Service.aspx/Check/	18,589
8	http://www.app.gov.al/ bundles/master/	14,108
9	http://www.app.gov.al/ të-tjera/arkiva/arkiva-e-buletinit-të-prokurimit-publik/	12,425
10	http://www.app.gov.al/ umbraco/RenderMvc/	10,567
11	http://www.app.gov.al/ njoftimi-i-kontratës-së-shpallur/	8,038
12	http://www.app.gov.al/ ep/default.aspx	6,440
13	http://www.app.gov.al/ ep/VKM.aspx/	6,009
14	http://www.app.gov.al/ prokurimet-me-vlere-te-vogel/	4,396
15	http://www.app.gov.al/ ep/MY_Workplace.aspx	4,033
16	http://www.app.gov.al/ të-tjera/arkiva/arkiva-e-buletinit-të-prokurimit-publik/ arkiva-e-buletinit-të-prokurimit-publik-2017/	3,871
17	http://www.app.gov.al/ bundles/masterjs/	3,796
18	http://www.app.gov.al/ legjislacioni/prokurimi-publik/ ligji/	3,698





Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, interesi kryesor është në ndërfaqen e logimit në sistemin e prokurimit elektronik, arkivën e Njoftimeve të buletineve të prokurimit publik, Legjislacioni, Njoftim të kontratave të shpallura, etj.



6.2.5.8. Aktiviteti i përdoruesve sipas fjalëve kyc më të përdorura për kërkimin e portalit të APP.

Tabela dhe Grafiku i mëposhtëm pasqyrojnë fjalët e përdorura më shpesh për të kërkuar në internet portalin e APP dhe Sistemin e Prokurimit Elektronik:

Google	Phrase	Visitors
1	agjencia e prokurimit publik	169,119
2	app.gov.al	542
3	buletini app	172
4	www.app.gov.al	168
5	app	94
6	app.gov.al login	50
7	buletini i prokurimit publik 2017	46
8	prokurimet publike	33
9	agjencia e prokurimeve publike	29
10	ligji i prokurimit publik	28
11	app.gov.al	25
12	www.app.gov.al login	23
13	buletini i prokurimit publik	22
14	ligji per prokurimin publik	21
15	prokurim elektronik	21
16	agjencia e prokurimit publik	21
17	agjencia e prokurimeve	20
18	gov.al	18
19	app.gov.al buletini	18
20	prokurimi publik	16
--	--	--






6.2.5.9. Aksesimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik sipas shfletuesve dhe sistemeve operative.

Tabela dhe Grafiku i mëposhtëm pasqyrojnë aksesimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik sipas shfletuesve të kërkimit:

Most Used Browsers

	Browser	Hits	Visitors	% of Total Visitors
1	Google Chrome	226,066,885	1,078,322	65.35%
2	Firefox	51,523,113	207,351	12.57%
3	Internet Explorer	40,687,154	165,828	10.04%
4	Mobile Safari	2,265,475	69,052	4.18%
5	Microsoft Edge	8,737,816	37,771	2.29%
6	Opera	2,319,669	14,692	0.89%
7	Others	1,867,419	9,287	0.56%
8	Safari	561,825	8,801	0.52%
9	Android Browser	200,975	4,828	0.28%
10	Microsoft Office Protocol Discovery	15,170	3,482	0.21%
11	Microsoft Office Existence Discovery	8,474	3,348	0.20%
12	Microsoft-WebDAV-MiniRedir/6.1.7601	7,106	1,527	0.09%
13	Test Certificate Info	1,835	1,413	0.09%
14	MobileSafari/602.1 CFNetwork/811.5.4 Darwin/16.6.0	9,351	1,120	0.07%
15	Mozilla/5.0 (Linux; U; Android-4.0.3; en-us; Galaxy Nexus Build/IML74K) AppleWebKit/535.7 (KHTML, like Gecko) CrMo/16.0.912.75 Mobile Safari/535.7	1,163	957	0.06%
16	Mozilla/5.0 (Linux; U; Android-4.0.3; en-us; Xoom Build/IML77) AppleWebKit/535.7 (KHTML, like Gecko) CrMo/16.0.912.75 Safari/535.7	1,147	952	0.06%
17	MobileSafari/602.1 CFNetwork/811.5.4 Darwin/16.7.0	7,631	923	0.06%

Most Used Browsers





Me përfundimin e implementimit të kontratës për përmirësimin dhe shtimin e disa funksionaliteteve të reja për Sistemin e Prokurimit Elektronik, u bë e mundur aksesimi dhe funksionimi normal i të gjithave ndërfaqeve të sistemit nga të gjitha llojet e shfletuesve si Google Chrome, Mozilla Firefox, etj. Në krahasim me vitin 2016 ku shfletuesi më i përdorur ishte Internet Explorer, në vitin 2017 kemi Google Chrome dhe Mozilla Firefox.



6.2.5.10. Aksesimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik sipas llojeve të pajisjeve më të përdorura nga përdoruesit

Tabela dhe Grafiku i mëposhtëm pasqyrojnë aksesimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik sipas llojeve të pajisjeve (desktop, mobile, tablet etj) të përdorura nga përdoruesit:




Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, aksesimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik është më i lartë nga kompjuterat desktop/ laptop. Gjithsesi, verëhet një rritje në përdorimin e pajisjeve mobile.



6.2.5.11. Aksesimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik sipas sistemeve operative më të përdorur nga përdoruesit

Tabela dhe Grafiku i mëposhtëm pasqyrojnë aksesimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik sipas sistemeve operative të përdorura nga përdoruesit:

	Operating System	Hits	Visitors	% of Total Visitors
1	Windows 7	226,605,476	825,884	54.97%
2	Windows 10	51,852,723	209,078	13.92%
3	Android OS	5,222,033	148,449	9.88%
4	Windows XP	28,457,335	106,674	7.10%
5	iPhone	2,669,180	77,656	5.17%
6	Windows 8.1	12,299,249	49,988	3.33%
7	Others	2,980,878	23,746	1.58%
8	Mac OS	1,649,916	22,986	1.53%
9	Linux	1,855,465	14,091	0.94%
10	Windows 8	2,273,015	9,386	0.62%
11	Windows Vista	942,663	6,418	0.43%
12	iPad	115,656	2,098	0.18%
13	Windows Phone	57,499	1,836	0.12%
14	Windows NT	4,217	1,010	0.07%
15	Chrome OS	1,685,080	809	0.05%
16	iPod	4,212	742	0.05%



Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, si rezultat i përmirësimeve të kryera në Sistemin e Prokurimit Elektronik, është bërë e mundur aksesimi dhe funksionimi normal i të gjithave ndërfaqeve edhe nga pajisjet mobile me sistem iOS dhe Android.



7. Integrimi European dhe bashkëpunimi i Agjencisë së Prokurimit Publik me institucione të tjera

7.1 Integrimi european

APP ka vijuar raportimin periodik pranë Ministrisë së Integritit Evropian dhe Strukturave të përbashkëta BE-Shqipëri, në kuadër të procesit të Integritit Evropian dhe detyrimeve që ky proces shoqëron përsa i përket fushës së prokurimit publik.

Në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Integritit Evropian, APP në cilësinë e institucionit koordinues për Kapitullin 5: Prokurimi Publik ka organizuar takime të vazhdueshme të Grupit Ndërinstitucional të Punës për këtë kapitull, me qëllim diskutimin e rekomandimeve të dhëna në Komisioni European në raportin e tij për Shqipërinë në vitin 2016 dhe masat që duhet të merren për adresimin e tyre.

Në kuadër të përafrimit të legjislacionit në APP ka kërkuar asistencën e SIGMA për të hartuar një raport analitik të detajuar mbi shkallën e përputhshmërisë së legjislacionit aktual në fushën e prokurimit publik në Shqipëri me acquis-në e BE-së në këtë fushë, konkretisht direktivat 2014/23 për koncesionet, 2014/24 për prokurimet publike, 2014/25 për prokurimet në sektorët utilitarë, 2009/81 për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë dhe direktivat mbi procesin e rishikimit të ankesave.

Raporti i mësipërm (legislative gap analysis) ka marrë në shqyrtim të gjithë kuadrin ligjor që është pjesë e Kapitullit 5: prokurimi publik duke u fokusuar sidomos në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë procedurat e prokurimit në Shqipëri, kuadrin ligjor mbi koncesionet dhe partneritetin publik privat, kuadrin ligjor ekzistues mbi prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë si edhe dispozitat që rregullojnë procesin e ankimimit mbi procedurat e prokurimit dhe mënyrën e funksionimit të KPP.

Për sa më sipër, raporti përcakton në mënyrë të saktë:

1. Dispozitat konkrete të direktivave respektive të BE-së që konsiderohen të transpozuar plotësisht në legjislacionin shqiptar;
2. Dispozitat konkrete të direktivave respektive të BE-së që konsiderohen të transpozuar pjesërisht në legjislacionin shqiptar;
3. Dispozitat konkrete të direktivave respektive të BE-së që nuk janë transpozuar fare në legjislacionin shqiptar;
4. Rekomandime mbi transpozimin e dispozitave që nuk janë përafuar ende duke identifikuar se cilat prej tyre janë të detyrueshme për zbatim sipas parashikimeve të vetë direktivave si edhe afateve të mundshme për transpozimin e tyre.

Dokumenti i mësipërm është shumë i rëndësishëm, duke pasur parasysh fazën në të cilën ndodhet procesi i integritit të Shqipërisë dhe perspektivës të marrjes së shpejti të miratimit për hapjen e negociatave për anëtarësim nga ana e kështjellit European, duke qenë se ai do të shërbejë si bazë për zhvillimin e fazës së parë të procesit, 'screening' i legjislacionit.

Në datë 4 dhe 17 tetor 2017 u zhvilluan në Bruksel respektivisht Takimi i Tetë i Komiteteit të Stabilizim Asocimit dhe takimi i Nëntë i Nënkomitetit Bashkimi Evropian-Shqipëri "Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca, duke përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe të shëndetit", gjatë të cilëve APP raportoi në mënyrë të detajuar mbi progresin e arritur, në drejtim të përafrimit të legjislacionit në këtë fushë.



Nga ana e Komisionit Evropian u vlerësua e APP-së në këtë drejtim sidomos sa i takon përgatitjes së Legal Gap Analysis si dhe u dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me përmirësimin e sistemit të prokurimeve sidomos sa i takon koncesioneve.

Nga ana tjetër, Prokurimi Publik është pjesë e rëndësishme e tre Strategjive ndërsektoriale kryesore të Qeverisë Shqiptare, konkretisht, Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike, Strategjia Ndërsektoriale për Luftën kundër korrupsionit dhe Strategjia për Reformën në administratën Publike.

Në këtë kuadër, APP ka raportuar rregullisht për zbatimin e masave të parashikuara në këto dokumenta jo vetëm pranë institucioneve përgjegjëse për korrordinimin e tyre, por edhe pranë Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë apo institucioneve të tjera përgjegjëse për monitorimin e tyre.

7.2. Bashkëpunimi i APP me institucione të huaja

Gjatë vitit 2017, APP ka patur një bashkëpunim shumë të mirë me institucionet ndërkombëtare që veprojnë në fushën e prokurimit, ndër të cilat më të rëndësishmet janë:

- Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri me të cilin APP ka një bashkëpunim të vazhdueshëm sa i takon zhvillimeve që lidhen me prokurimin publik. Në këtë kuadër, APP ka bashkëpunuar ngushtësisht me këtë institucion për hartimin e ndryshimeve të ligjit të prokurimit me qëllim garantimin e pavarësisë së Komisionit të Prokurimit Publik.

Gjithashtu, APP ka pasur një bashkëpunim të vazhdueshëm me Delegacionin e BE-së edhe në kuadër të zhvillimeve në strategjitë ndërsektoriale në të cilat prokurimi publik është pjesë, sidomos Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike dhe Strategjia Antikorrupsion.

- SIGMA është një nga organizmat kryesorë e cila, në mënyrë të vazhdueshme, mbështet APP-në me ekspertizën e nevojshme sipas çështjeve. Në këtë kuadër, APP ka bashkëpunuar ngushtësisht me këtë organizëm gjatë vitit 2017 sidomos sa i takon hartimit të ndryshimeve të ligjit lidhur me pavarësinë e KPP dhe ndryshimeve të tjera të akteve nënligjore të finalizuara në fund të vitit.

Gjithashtu, me mbështetjen e SIGMA është përgatitur një Raport i detajuar mbi shkallën e përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me direktivat e BE-së në fushën e prokurimit, i cili është një dokument bazë mbi të cilin do të punohet për përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit me këto direktiva..

- Banka Botërore është gjithashtu një nga partnerët kryesorë në fushën e prokurimit publik, nëpërmjet ofrimit të asistencës së nevojshme financiare për realizimin e masave të caktuara ligjore apo teknike apo nëpërmjet konsulencës dhe rekomandimeve të vazhdueshme sa i takon përmirësimit të sistemit të prokurimit.

Në këtë kuptim, edhe gjatë vitit 2017, Banka Botërore ka qenë shumë aktive, duke mbështetur APP-në nëpërmjet projektit “Përmirësimi i kontrollit të përputhshmërisë dhe rritja e transparencës në prokurimin publik në Shqipëri”. Njëkohësisht, ky institucion ka qenë gjithashtu pjesë e grupit të punës për hartimin e ndryshimeve të ligjit për riorganizimin e KPP si institucion i pavarur.

Nga ana tjetër, gjatë vitit 2017, Banka Botërore finalizoi raportin e saj mbi sistemin e prokurimit publik në Shqipëri ku përfshihen gjetje, problematika të konstatuara dhe rekomandime të detajuara për përmirësimin e sistemit të prokurimit në Shqipëri.

Gjithashtu, APP ka bashkëpunuar ngushtësisht me këtë institucion edhe në kuadër të vlerësimit PEFA të zhvilluar gjatë vitit në lidhje me Menaxhimin e financave publike në Shqipëri, për të cilin ka luajtur rolin e koordinatorit të procesit brenda vendit.



7.3. Bashkëpunimi i APP me institucione të tjera në Shqipëri

APP është institucioni përgjegjës për këshillimin e Autoriteteve Kontraktore dhe dhënien e asistencës së vazhdueshme për realizimin e procedurave të prokurimit. Në këtë kuadër, APP ka bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme me Autoritetet Kontraktore, duke ofruar vazhdimisht asistencën e saj si edhe duke dhënë sqarimet e nevojshme për të gjitha kërkesat e dorëzuara prej tyre në institucion me qëllim zbatimin sa më korrekt të legjislacionit të prokurimit publik, legjislacionit të koncesioneve dhe partneritetit publik privat dhe atij të ankandit publik.

Ky bashkëpunim është intensifikuar akoma më shumë gjatë tremujorit të fundit të vitit me ndryshimin e qasjes së APP-së dhe marrjen e një roli proaktiv të saj në këtë drejtim.

Gjithashtu, në kuadër të përmirësimit të zbatimit të legjislacionit nga ana e autoriteteve kontraktore, APP ka vijuar të ketë një bashkëpunim shumë të mirë edhe me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), për organizimin e trajnimeve për autoritetet kontraktore.

Sikundër edhe gjatë viteve të tjera, edhe në 2017 APP ka patur një bashkëpunim shumë të ngushtë dhe intensiv me Ministrinë përgjegjëse për Integrimin Europian, duke raportuar në mënyrë periodike mbi progresin e arritur në drejtim të zbatimit të angazhimeve dhe detyrimeve të Qeverisë Shqiptare në fushën e prokurimit publik.

Në kuadër të raportimit të mësipërm dhe ndjekjes së aktiviteteve të tjera lidhur me procesin e integritetit, APP ka bashkëpunuar ngushtësisht edhe me Komisionin e Prokurimit Publik, Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Brendshme dhe DSIK, si institucione anëtare të Grupit Ndërinstitucional të Punës për Kapitullin 5.

Gjithashtu, në kuadër të implementimit të Strategjive kryesore të Qeverisë Shqiptare në të cilat prokurimi publik është pjesë, konkretisht, Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike, Strategjia Kombëtare për luftën kundër korrupsionit dhe Strategjia ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike, APP ka bashkëpunuar ngushtësisht me institucionet përgjegjëse për koordinimin e tyre dhe konkretisht, Ministrinë e Financave, Ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore dhe Ministrin e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.

Për sa më sipër, APP ka raportuar në mënyrë periodike lidhur me statusin e zbatimit të masave respektive për këto strategji dhe ka marrë pjesë rregullisht në takimet e zhvilluara për këtë qëllim.

Sikurse në vitet e kaluara, në ushtrimin e detyrave të saj ligjore, APP ka vijuar bashkëpunimin me institucionin e Komisionit të Prokurimit Publik sidomos për sa i takon njoftimeve të dërguara nga KPP në rastet e marrjes së vendimeve për pezullimin e procedurave të prokurimit, me qëllim që ky vendim të pasqyrohet në sistemin e prokurimit elektronik për mosprocedimin e mëtejshëm nga ana e autoriteteve kontraktore siç parashikohet edhe në dispozitat e legjislacionit të prokurimit publik. Ky bashkëpunim evidentohet edhe në rastin e pasqyrit në sistemin e prokurimit elektronik të vendimeve të dhëna nga KPP, në përfundim të shqyrtimit të ankesave.

Me qëllim unifikimin e interpretimit të legjislacionit dhe qëndrimit të të dy institucioneve për çështje të caktuara, janë nxjerrë rekomandime të përbashkëta drejtuar Autoriteteve Kontraktore dhe Operatorëve Ekonomikë.

Në kuadër të disa ndryshimeve në rregullat e prokurimit publik, me qëllim përmirësimin e tyre, APP ka bashkëpunuar me një sërë institucionesh si, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, Drejtoria e Përgjithshme e Markave dhe Patentave, Autoriteti Rrugor Shqiptar si edhe Shoqata të ndryshme si psh. Shoqata e Ndërtuesve e cila ka dhënë sugjerimet e saj në lidhje me përmirësimin e rregullave të prokurimit për shërbimet e konsulencës.



Për sa më sipër, APP ka bashkëpunuar ngushtësisht edhe me institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili ka dhënë rekomandimet e tij për këtë qëllim, në cilësinë e organit më të lartë auditues në vend.

Duhet theksuar se APP bashkëpunon të mënyrë të vazhdueshme me këtë institucion, sidomos sa i takon shqyrtimit të raporteve të auditit të dërguara nga ky i fundit dhe gjetjeve e problematikave të konstatuara në procedurat e prokurimit të zhvilluara nga autoritetet kontraktore.

Gjatë këtij viti, bashkëpunimi me KLSH ka qenë shumë intensiv duke pasur parasysh që APP ka qenë subjekt auditimi nëpërmjet dy programeve të ndryshme auditimi, (i) Auditim performance për procedurat e prokurimit publik dhe (ii) Auditim përputhshmërie me legjislacionin buxhetor dhe atë të menaxhimit financiar.

Në këtë kuadër, është bashkëpunuar ngushtësisht për përmirësimin e veprimtarisë së APP-së nisur nga rekomandimet e KLSH.

7.4 Asistenca e projekteve të huaja

Edhe gjatë vitit 2017, APP ka vijuar të zbatojë projektin e Bankës Botërore “Përmirësimi i monitorimit të përputhshmërisë dhe rritja e transparencës në prokurimin publik në Shqipëri”, i cili u finalizua në muajin Nëntor 2017.

Qëllimi kryesor i projektit ishte mbështetja e Qeverisë Shqiptare për të përmirësuar dhe përforcuar më tej sistemin e monitorimit të përputhshmërisë me ligjin për prokurimin publik, për të përmirësuar mekanizmat e shqyrtimit të ankesave, si edhe për të rritur kapacitetet e KLSH për auditimin e kontratave të prokurimit publik në Shqipëri.



8. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE, DHE FINANCËS

8.1 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

APP edhe përgjatë vitit 2017 e ka ushtruar aktivitetin e saj ligjor me 2 (dy) drejtori dhe 1 (një) sektor në varësi direkte të Drejtorit të Përgjithshëm, përkatësisht: (i) Drejtorinë Juridike dhe Monitorimit me 2 (dy) sektorë (Sektori i Monitorimit dhe Sektori Juridik); (ii) Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Publikimit me 2 (dy) sektorë (Sektori i Publikimit dhe Sektori Teknologjisë së Informacionit) si dhe (iii) Sektorin e Integritetit, Burimeve Njerëzore dhe Financës. Numri total i punonjësve në institucion është 29 (njëzet e nëntë).

8.2 Autoriteti Përgjegjës

Autoriteti Përgjegjës në institucion, ka mbajtur në mënyrë të rregullt kontaktet me Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe ka raportuar emrat e personave përgjegjës për deklarin e pasurive në institucion, si dhe ka dërguar në kohë deklarinet përkatëse.

Gjatë këtij viti, APP në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga ligji “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe nëpunësve publik”, ka depozituar në kohë Deklarimin e Interesave Privatë Periodik/Vjetor dhe Deklarimin e Interesave Para Fillimit të Detyrë, sipas legjislacionit në fuqi.

8.3 Aktivitetet në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve administrative të stafit të APP dhe specialistëve të prokurimit publik pranë autoriteteve kontraktore

8.3.1 Pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare

Gjatë vitit 2017 përfaqësues të APP kanë marrë pjesë në një sërë takimesh dhe seminaresh të organizuar brenda dhe jashtë vendit dhe konkretisht si më poshtë:

Në muajin Shkurt 2017, 2(dy) përfaqësues nga APP morën pjesën në Workshop-in e organizuar nga Ministria e Mbrojtjes në Bashkëpunim me TAIEX lidhur me prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë dhe transpozimin e Direktivës përkatëse në legjislacionin shqiptar.

Përfaqësues të APP morën pjesë gjithashtu në Takimin e përbashkët rajonal mbi prokurimin elektronik që u zhvillua në Lubjanë, Slloveni në muajin Mars 2017.

Në muajin Prill 2017, 2 (dy) punonjës të APP u bënë pjesë e trajnimit me temë “EU Negotiations Skills”, të organizuar në kuadër të projektit të binjakëzimit për mbështetjen e Reformës në Administratën Publike pranë ASPA.

Në muajin Maj 2017, APP u përfaqësua në forumin e 13-të të Prokurimit, Integritetit, Menaxhimit dhe Transparencës (PRIMO) mbajtur në Kiev, Ukrainë nga 2 (dy) punonjës të saj.

Gjithashtu në muajin Maj 3 (tre) punonjës nga APP morën pjesë në workshopin rajonal “Mbi Prokurimin e shërbimeve të përkthimit”, organizuar nga Shkolla Rajonale e Administratës Publike, RESPA, në bashkëpunim me GIZ (German Cooperation) në Beograd, Serbi.



Në Qershor të vitit 2017, me ftesë të Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore dhe TAIEK, APP u bë pjesë e Workshop-it Rajonal mbi barrierat në mirëqeverisje të organizuar në Trieste, Itali ku mori pjesë një punonjës i saj.

Në Nëntor 2017, me ftesë të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes, një përfaqësues nga APP u bë pjesë e kursit të avancuar global për prokurimin publik organizuar në Gjenevë nga Organizata Botërore e Tregtisë (OBT), me në fokus njohjen e zbatimit në praktikë të Marrëveshjes për Prokurimet Qeveritare (GPA) me qëllim vlerësimin e antarësimit të Shqipërisë në këtë marrëveshje.

8.3.2 Trajnimet e punonjësve të prokurimeve pranë Autoriteteve Kontraktore

APP, me qëllim njohjen e punonjësve të ngarkuar me kryerjen e procedurave të prokurimit publik në Autoritetet Kontraktore të pushtetit qendror dhe vendor, ka organizuar disa seanca trajnimi në fushën e prokurimit publik.

Edhe përgjatë vitit 2017, APP ka vijuar bashkëpunimin me Shkollën e Administratës Publike (ASP), në zhvillimin e trajnimeve në fushën e prokurimit publik duke organizuar në total 5 sesione trajnimi 9 (nëntë) ditore gjatë të cilave janë trajnuar gjithsej 128 punonjës prokurimi.

Gjithashtu, në kuadër të masave të marra gjatë tremujorit të fundit të vitit 2017 me qëllim reduktimin e numrit të procedurave të prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe rritje së përdorimit të marrëveshjes kuadër për blerjen e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme, APP ka bashkëpunuar me ASPA për organizimin e 4 sesioneve 1 ditore të trajnimit me punonjësit e bashkive ku janë trajnuar gjithsej 48 punonjës.

Për sa më sipër, vetë APP ka organizuar edhe 4 sesioneve 1 ditore me institucionet qendrore apo ente të tjera publike për përdorimin e marrëveshjes kuadër ku janë trajnuar 64 punonjës. Si perfundim, numri total i punonjësve të prokurimit të trajnuar gjatë vitit 2017 është 234.

Tabela e mëposhtme tregon numrin e të trajnuarve në total për vitin 2017, sipas llojit të trajnimit:

Nr.	Insitucioni organizues	Trajnimi	Kohëzgjatja	Autoritetet kontraktore	Numri i trajnimeve	Numri i të Trajnuarve
1	APP+ASPA	Prokurimi publik	9 (nëntë) ditore	Të gjitha	5(shtatë)	128
2.	APP+ASPA	Marrëveshja kuadër	1 (një) ditore	Bashkitë	4 (katër)	42
3	APP	Marrëveshja kuadër	1 (një) ditore	Institucione qendrore dhe ente të tjera	4 (katër)	64
Totali	234 nëpunës					



8.4 Gjendja financiare e Agjencisë së Prokurimit Publik për vitin 2017

Mbështetur në Ligjin nr. 130, datë 15.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, situata buxhetore me treguesit e realizimit të buxhetit të institucionit Agjencia Prokurimit Publik, për periudhën Janar – Dhjetor 2017, paraqitet si vijon:

Në lekë

	Emërtimi	Plan vjetor 2017	Plan i rishikuar	Fakt 12/Mujor	Në %
1	Shpenzime paga	26 000 000	26 900 000	26 509 114	98.5%
2	Sigurime Shoqërore	4 100 000	4 400 000	4 282 301	97.3%
3	Mallra Shërbime	19 200 000	6 200 000	3 934 412	63.4%
4	Shpenzime për investime	6 000 000	6 000 000	766 416	13%
	Totali i shpenzimeve	55 300 000	43 500 000	35 492 243	81.6%
5	Fonde nga FZHR	142 507 150	139 627 350	132 456 157	94.8%
	Buxheti+FZHR	197 807 150	183 127 350	167 948 400	91.7%

Konkluzioni kryesor që nxirret nga analizimi i tabelës së mësipërme, është se shpenzimet e përgjithshme të APP-së, në fund të vitit 2017, janë realizuar në masën 81.6 % e buxhetit të rishikuar, ose rreth 8 007 000 lekë më pak se plani i ndryshuar me Aktin Normativ Nr. 3, datë 06.11.2017.

600-601 Artikulli “Paga dhe sigurime shoqërore”

Buxheti i miratuar për vitin 2018 për zërin “paga dhe sigurime shoqërore” pati mungesë financimi për 1 000 000 lekë, nisur nga kërkesat tona buxhetore gjatë përgatitjes së PBA, në përputhje me numrin e punonjësve. Me rritjen e pagave të punonjësve, nga efekti financiar i rritjes së tyre dhe mungesa e financimit të fillimit të vitit, bazuar në kërkesën tonë, nga Ministria e Financave u bë çelja e fondeve për paga për 1 200 000 lekë.

Në fund të vitit, zëri paga dhe sigurime rezulton me mospërdorim të fondit për 508.000 lekë. për arsye të mos plotësimit të vendeve vakant të punonjësve të larguar gjatë vitit.

602- Artikulli “Shpenzime për mallra e shërbime”

Buxheti i miratuar për vitin 2018 për zërin “Shpenzime operative” në shumën për 19 000 000 lekë, u paksua me 13 000 000 lekë me Aktin Normativ Nr. 3, datë 06.11.2017, pasi kjo shumë ishte planifikuar në PBA për shpenzime për mirëmbajtje sistemi, por që për vitin 2017 ky shërbim mbulohej me fondet e investimeve të akorduara nga Fondi i Zhvillimit Rajonal.

Gjithashtu edhe nga realizimi i procedurave të prokurimit gjatë vitit 2017, rezultuam me mospërdorim të fondit të parashikuar për rreth 2 200 000 lekë, ose realizuar 63.4%.

231- Artikulli “Shpenzimet kapitale”

Shpenzimet për investime nga 6 000 000 lekë të miratuara u realizuan 766 000 lekë ose 13%, që ishin blerje paisje dhe orendi zyre. Fondi i parashikuar për blerje paisje për sistemin nuk u përdor, për arsye se paisjet e planifikuara për sistemin elektronik u realizuan në zërin “Infrastrukturë e re dhe ri-inxhinierim i arkitekturës hardware” me fondet e investimeve të akorduara nga Fondi i Zhvillimit Rajonal për programin “Shqipëria Dixhitale” për projektet “Ri-inxhinierim dhe shtim funksionalitetesh/shërbimesh në sistemin e prokurimit elektronik mbështetur nga një teknologji dhe infrastrukturë e re”.



Bazuar në treguesit e realizimit të buxhetit, mund të vëmë re se situata ekonomike gjatë vitit 2017, për institucionin tonë ka qenë e favorshme. Në përgjithësi të gjithë zërat e buxhetit janë realizuar në masën e planifikuar në Projekt Buxhetin Afatmesëm 2017-2019. Shpenzimet dhe investimet më të rëndësishme dhe të domosdoshme për Agjencinë e Prokurimit Publik janë realizuar me efikasitet, duke bërë që puna të vijojë më me efektshmëri dhe duke plotësuar nevojat e punonjësve për një mjedis të përshtatshëm pune.



9. PRIORITETET E AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN 2018

Pavarësisht arritjeve dhe përmirësimeve të realizuara gjatë vitit 2017, një nga sfidat kryesore të APP edhe për vitin 2018 vazhdon të mbetet përmirësimi i sistemit të prokurimit në Republikën e Shqipërisë.

Prioritetet kryesore të veprimtarisë së APP për vitin 2018 janë si vijon:

I. Përmirësimi i efencës në përdorimin e fondeve publike

Përdorimi në mënyrë sa më eficiente i fondeve publike lidhet ngushtësisht me një sërë faktorësh, nga planifikimi i procedurave deri në zbatimin e kontratës. Për këtë qëllim, APP synon të rrisë rolin e saj monitorues në lidhje me zbatimin në kohën dhe mënyrën e duhur të kontratave të nënshkruara nga Autoritetet Kontraktore nëpërmjet krijimit të një mekanizmi raportimi dhe monitorimi për këtë qëllim.

II. Përmirësimi i planifikimit të procedurave të prokurimit-

Planifikimi i kujdesshëm dhe në kohën e duhur i procedurave të prokurimit është një nga kushtet kryesore për rritjen e efencës në përdorimin e fondeve publike. Kështu, në vijim të përfshirjes në sistemin e prokurimit elektronik të regjistrit të parashikimeve dhe regjistrit të realizimeve për procedurat e prokurimit publik, APP do të marrë të gjitha masat e nevojshme për ndërgjegjësimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të Autoriteteve Kontraktore për këtë qëllim.

III. Ulja e numrit të procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës

APP do të vazhdojë punën e nisur gjatë vitit 2017 për minimizimin e përdorimit të procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës duke ndërgjegjësuar autoritete kontraktore për zbatimin e drejtë të parashikimeve ligjore. Gjithashtu, APP synon uljen drastike të numrit të këtyre lloj procedurave nëpërmjet zhvillimit të tyre në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe monitorimit të vazhdueshëm që në momentin e parë të krijimit në sistem.

IV. Rritja e përdorimit të Marrëveshjes Kuadër nga Autoritetet Kontraktore

Marrëveshja Kuadër është një nga instrumentet kryesore për të garantuar disponibilitetin e mallrave dhe shërbimeve me natyrë të vazhdueshme për autoritetet kontraktore, duke eliminuar periudhat e pambuluara me nevoja për këto lloj produktesh. Në këtë kuadër, APP do të vazhdojë punën për ndërgjegjësimin e autoriteteve kontraktore për përdorimin e Marrëveshjes Kuadër.

V. Përmirësimi i kuadrit institucional

Përmirësimi i kuadrit institucional në fushën e prokurimit ka qenë vazhdimisht një nga rekomandimet kryesore të institucioneve monitoruese vendase dhe të huaja. Në këtë kuadër, drejtimet kryesore të punës së APP për këtë qëllim janë fuqizimi i APP si një institucion politikëbërës nëpërmjet rritjes së numrit të stafit, buxhetit dhe shtimit të kompetencave në të gjithë procesin e prokurimit, përfshirë edhe monitorimin e zbatimit të kontratave nga ana e autoriteteve kontraktore dhe rritjen e rolit proaktiv të APP për asistimin e Autoriteteve Kontraktore në fazën paraprake të tenderit. Gjithashtu, një nga objektivat kryesorë të punës së APP në këtë drejtim është edhe rishikimi i numrit të Autoriteteve Kontraktore që janë aktive në sistemin elektronik me qëllim reduktimin e tij dhe rritjen e efencës në procedurat e prokurimit.

VI. Përmirësimi i kapaciteteve administrative

Me qëllim përmirësimin e kapaciteteve administrative në fushën e prokurimit, APP ka hartuar tashmë një plan trajnimi për trajnimin e Autoriteteve kontraktore. Gjithashtu, APP synon t'u vijë në ndihmë autoriteteve kontraktore edhe nëpërmjet rritjes së rolit të saj në dhënien e asistencës së vazhdueshme në fazën paraprake të përgatitjes së tenderit.



VII. Përmirësimi i kuadrit ligjor

Me rëndësi të veçantë në këtë drejtim është përmirësimi dhe përafrimi i legjislacionit në fushën e prokurimit me direktivat përkatëse të BE-së, duke pasur gjithashtu në konsideratë edhe rekomandimet e dhëna nga Banka Botërore dhe SIGMA në raportet e tyre më të fundit.

VIII. Përpunimi i të dhënave dhe përgatitja e Statistikave

Përpunimi i të dhënave dhe përgatitja në një kohë sa më të shpejtë të statistikave në lidhje me funksionimin e sistemit të prokurimit në Shqipëri është shumë e rëndësishme duke qenë se ajo është një nga treguesit kryesorë të mirëmenaxhimit të fondeve publike.



ANALIZA VJETORE 2017



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK